



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Ministarstvo Industrije,
Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade*

UDHËZIMI ADMINISTRATIV(MINT) Nr. 03/2024
PËR KËRKESAT TEKNIKO –METROLOGJIKE PËR EMËRIMIN E TRUPAVE PËR
VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR FUSHAT SPECIFIKE TË METROLOGJISË
LIGJORE

Ministri/ja i Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Në mbështetje të nenit 35 paragrafi 3 dhe paragrafi 7 të Ligjit Nr. 06/L -037 Për Metrologji(Gazetë Zyrtarë e Republikës së Kosovës Nr. 7/8 Maj 2018 , Shtojcës 12 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 të Rregullores e Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15/ 12.09.2011), nxjerr:

UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MINT) Nr. 03/2024 PËR KËRKESAT TEKNIKO – METROLOGJIKE PËR EMËRIMIN E TRUPAVE PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR FUSHAT SPECIFIKE TË METROLOGJISË LIGJORE

Neni 1 Qëllimi

Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen procedurat e vlerësimit, kërkesat tekniko – metrologjike për emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit në fushat e specifike të metrologjisë ligjore.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e këtij Udhëzimi administrativ vlejné për Trupat e emëruar që kryejné vlerësimin e konformitetit, respektivisht verifikimin e mjeteve matëse ligjore dhe matjet zyrtare për fushat specifike të metrologjisë ligjore në tërë territorin e Republikës së Kosovës .

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këto kuptime:

- 1.1. Agjencia e Metrologjisë së Kosovës (AMK);
- 1.2. Trupave për Vlerësim të Konformitetit (TVK);
- 1.3. Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK)
- 1.4. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)
- 1.5. The International Organization of Legal Metrology - OIML
- 1.6. The European Cooperation in Legal Metrology - WELMEC

Neni 4

Procedura për aplikim

Subjektet juridike të interesuara mund të aplikojnë për marrjen e emërimit për kryerjen e punëve sipas fushave të specifikuara në nenin 13 të këtij udhëzimi administrativ pas publikimit të ftesës publike nga AMK.

Neni 5

Dokumentacioni përcjellës i kërkesës për emërim

1. Subjektet juridike të cilat aplikojnë për emërim përveç kritereve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ përkatës për Mënyrën e Emërimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit, duhet të posedojnë dokumentet e nevojshme si:

- 1.1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me dokumentacion përcjellës;
- 1.2. Certifikata e akreditimit sipas standardit SK ISO/IEC 17020 të lëshuar nga një trup kombëtar i akreditimit;
- 1.3. Procedurat të verifikimit të mjeteve matëse nga fusha e emërimit që aplikon
- 1.4. Manualin e përdorimit dhe të mirëmbajtjes të pajisjeve që përdoren për verifikimin e mjetit matës;
- 1.5. Dëshminë mbi përgatitjen profesionale të personit përgjegjës për kryerjen e detyrave të metrologjisë për fushën e caktuar të emërimit.
- 1.6. Dëshminë që aplikuesi nuk është i përfshirë në aktivitete të cilat mund të bien ndesh me pavarësinë dhe paanshmërinë e aktiviteteve të vlerësimit të konformitetit- deklaratë e paanshmërisë dhe që është i pavarur në punën e vlerësimit të konformitetit.
- 1.7. Fotokopjen e noterizuar të lejes së njoftimit të personit përgjegjës,
- 1.8. Nëse personi përgjegjës nuk është shtetas i Republikës së Kosovës duhet të sjellë dëshminë e leje qëndrimit nga MPB;
- 1.9. Kontratën e punës me personin përgjegjës, me vlefshmëri për së paku tre (3) vite;
- 1.10. Lista e pajisjeve - etalonëve për verifikimin e mjeteve matëse, me të dhëna teknike të pajisjeve-etalonëve, duke përfshirë edhe afatin kohor ri-kalibrues;
- 1.11. Certifikatat e kalibrimit të pajisjeve (etalonëve) nga fusha e emërimit, të lëshuar nga laboratorët e AMK-së të cilët kane të ndërtuar sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas standardit SK EN ISO/IEC 17025 dhe që kanë arritur kompetencë profesionale, ose laborator i akredituar apo Institut Nacional i Metrologjisë (NMI) ndërkombëtare;
- 1.12. Certifikatën nga Policia e Kosovës për personin juridik dhe personat fizik që nuk janë nën hetime të ndërlidhur me veprimtarinë që e ushtrojnë (me afat të vlefshëm).
- 1.13. Certifikatën nga evidenca penale, e lëshuar nga gjykata (me afat të vlefshëm);
- 1.14. Vërtetimin tatimor që nuk ka borxhe tatimore apo obligime tjera tatimore të pashlyera ndaj ATK-së;
- 1.15. Certifikatë nga gjykata kompetente se subjekti juridik nuk është në procedurë të falimentimit;
- 1.16. Polica e sigurimit ose garancioni bankar në vlerë prej 10.000,00€ për kompensimin e dëmeve të shkaktuara gjatë punës së tyre dhe ndaj personave të tretë.
- 1.17. Deklaratën se të ardhurat e menaxhmentit dhe personelit nuk ndikohen nga numri i verifikimeve të kryera.

Neni 6

Kërkesat tekniko –metrologjike për emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit

1. Subjektet juridike duhet t'i plotësojnë kërkesat tekniko-metrologjike të përcaktuara me këtë udhëzim administrativ, siç janë:

- 1.1. Të posedojnë etalonët përkatës dhe pajisje teknike;
- 1.2. Hapësirë të përshtatshme për verifikim e mjeteve matëse;
- 1.3. Personel të nevojshëm profesional.

2. Kërkesat nga nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 i këtij neni janë të përcaktuara në shtojcat e këtij udhëzimi administrativ.

Neni 7 Personeli

1. Subjekti juridik duhet të ketë së paku dy punonjës të cilët kryejnë punët e verifikimit të mjeteve matëse.

2. Njëri punonjës duhet të jetë person përgjegjës me kualifikim universitar profesional, ndërsa punonjësi tjetër duhet të ketë së paku shkollën e mesme teknike profesionale, për kryerjen e verifikimeve të mjeteve matëse dhe detyrave të metrologjisë për fushën për të cilën emërohet.

3. Personi përgjegjës duhet të jetë me përgatitje universitare: Fakulteti i shkencave natyrore-drejtimi i fizikës, kimisë; makinerisë; komunikacionit; elektroteknikës, dhe teknologjisë së përgjithshëm,

4. Punonjësit sipas paragrafit 1 dhe personi përgjegjës profesional nga paragrafi 3 të këtij neni, duhet të posedojnë certifikata të trajnimit nga fusha e emërimit dhe të kenë përvojë pune se paku 1 vite në fushën e njëjtë.

5. Personi përgjegjës profesional duhet të njoh legjislacionin në fushën e metrologjisë, rekomandimet OIML-së, udhëzuesit e WELMEC-ut dhe metodat e verifikimit të mjeteve matëse të cilat e mbulojnë fushën për të cilën emërohet.

Neni 8 Detyrimet e trupave të emëruara

1. Trupat e emëruara, për kryerjen e verifikimit të mjeteve matëse ligjore duhet:

- 1.1. Të ushtrojnë veprimtarinë nga fushat e emërimit në mënyrë profesionale dhe të vazhdueshme në pajtim me rregulloret dhe vendimin për emërim;

1.2. Të njoftoj AMK-në në afat prej shtatë (7) ditësh për çfarëdo ndryshimi të kushteve të emërimit në lidhje me hapësirën e punës, pajisjet, personelin dhe dokumentacionin dhe të raportoj sa herë që i kërkohet nga ana e AMK-së;

1.3. Pas njoftimit për ndryshimet sipas paragrafit 1.2, TVK-të nuk duhet të aplikojnë ndryshimet pa marrë konfirmim nga AMK .

1.4. Të prezantojnë dokumentet e kërkuara, kur kjo i kërkohet gjatë monitorimit nga mbikëqyrja metrologjike dhe nga komisioni për emërim të TVK-së

1.5. Të dërgojnë raportin e punës për çdo tre (3) muaj në AMK mbi verifikimet e kryera të mjeteve matëse ligjore si dhe raportin e përgjithshëm vjetor jo më vonë se 31 janari i vitit vijues dhe të raportoj sa herë që i kërkohet nga ana e AMK-së;

1.6. Duhet t'i ofrojë Mbikëqyrjes Metrologjike të gjitha informatat e duhura dhe dokumentet e kërkuara;

1.7. T'i zbatojë aktet ligjore dhe nënligjore si dhe procedurat nga fusha e metrologjisë që kanë të bëjnë me emërimin e dhënë;

1.8. Certifikata e verifikimit e cila lëshohet nga ana e trupës së emëruar duhet të nënshkruhet nga personi përgjegjës.

1.9. Të mos merret me prodhimin, importimin, shitjen apo riparimin (servisimin) e mjeteve matëse nga fushat e emërimit;

1.10. Tarifat e shërbimeve duhet t'i përmbahen Udhëzimi Administrativ për lartësinë dhe procedurën e pagesës për shërbime në Metrologji.

2. Trupat e emëruara duhen të posedojnë evidencën mbi matjet dhe verifikimet e kryera.

3. Trupat emëruara janë të obliguara të ruajnë dokumentacionin e verifikimit të mjeteve matëse ligjore në forme elektronike dhe kopje fizike, në afat jo më pak se tetë (8) vite.

4. Trupat e emëruara duhet në mënyrë të rregullt të shlyejnë detyrimet e përfitimeve publike deri më 15 dhjetor të çdo viti dhe të paraqesë dëshminë e lëshuar nga ATK-ja se i ka kryer këto obligime, këtë dëshmi ta prezantoj çdo fund viti në AMK.

5. Dëshminë nga Administrata Tatimore e Kosovës që stafi i trupës së emëruar janë në marrëdhënie pune në kuadër të trupës së emëruar dhe janë duke iu kryer në mënyrë efektive tatimet dhe kontributet pensionale sipas deklarimeve të parapara.

6. Pas nxjerrjes së vendimit për emërim, trupa e emëruar për vlerësim të konformitetit për fushat e specifike të metrologjisë ligjore, duhet t'i paguajë shpenzimet e procedurës sipas udhëzimi administrativ për lartësinë dhe procedurën e pagesës për shërbimet në metrologji.

Neni 9

Monitorimi i trupave për vlerësim të konformitetit për fushat specifike në metrologjinë ligjore

1. Për zbatimin e kriterëve në përputhje me kërkesat e udhëzimit administrativ (QRK) për mënyrën e emërimit të trupave për vlerësim të Konformitetit dhe kërkesat tekniko-metrologjike të përcaktuar në këtë Udhëzim Administrativ, TVK monitorohen nga Mbikëqyrja Metrologjike.
2. Shkeljet e gjetura nga Mbikëqyrja metrologjike duhet të adresohen te Komisioni për emërimin e TVK-ve përmes drejtorit të përgjithshëm të AMK-së.
3. Në rastet kur vërtetohet se Trupat e emëruara kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe vendimin për emërim, Komisioni për emërim i rekomandon Ministrit/es marrjen e masave në pajtim me udhëzimi administrativ për mënyrën e emërimit të trupave për vlerësim të konformitetit (QRK).

Neni 10

Masat për trupat e emëruara

Trupa e emëruar, ndaj të cilit janë marrë masa sipas paragrafit 3 të nenit 9 , i njëjti nuk mund të parashtrij kërkesë të re për emërim në afatin kohor brenda 3 (tre) viteve nga dita e shfuqizimit të vendimit.

Neni 11

Afati i vlefshmëri së vendimit

1. Afati i vlefshmërisë së Vendimit të emërimit për trupat për vlerësim të konformitetit për mjetet matëse ligjore është dy vite.
2. Nëse afati i vlefshmërisë së certifikatës së akreditimit është më i shkurtër se sa afati i përcaktuar në udhëzimit administrativ të cekur më lartë, atëherë vlefshmëria e vendimit për emërimin është deri në skadimin e afatit të certifikatës së akreditimit.

Neni 12

Dispozita shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ Shfuqizohet Udhëzimi Administrativ (MTI) Nr. 12/2020 për kërkesat tekniko–metrologjike për emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit për fushat e aplikueshme të metrologjisë ligjore.

Neni 13

Shtojcat

1. Shtojcat prej 1 deri 22 janë pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ:

- 1.1. Shtojca 1 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore të gjatësisë dhe këndit;
- 1.2. Shtojca 2 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore automatike të nivelit të lëngjeve në rezervuarët (enët) e palëvizshëm (AMR);
- 1.3. Shtojca 3 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore për rezervuarët cilindrikë horizontale dhe vertikale;
- 1.4. Shtojca 4 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore ujëmatësve dhe/ose mjeteve matëse të rrjedhjes së ujit;
- 1.5. Shtojca 5 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore të energjisë termike;
- 1.6. Shtojca 6 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore dhe sistemeve matëse ligjore për matjen e sasisë së lëngjeve të ndryshme nga uji;
- 1.7. Shtojca 7 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore për verifikimin e pajisjeve që tregojnë vëllimin;
- 1.8. Shtojca 8 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore të rrjedhjes së vëllimit të gazit (gazmatësit);
- 1.9. Shtojca 9 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore me të cilat korrigjohet vëllimi i gazit të rrjedhur (korrektorët);
- 1.10. Shtojca 10 Për verifikim e mjeteve matëse ligjore të masës;
- 1.11. Shtojca 11 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore të lagështisë së kokrrave të drithërave dhe farave për prodhimin e vajit (matësit e lagështisë);
- 1.12. Shtojca 12 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore për verifikimin e termometrave;
- 1.13. Shtojca 13 Për verifikimin mjeteve matëse ligjore e manometrave, vakumetrave, manovakuumometrave, konvertuesve (shndërruesve) matës të presionit, aparateve për matjen e presionit të gjakut, aparateve për matjen e presionit të gomave (mjeteve matëse të të presionit);
- 1.14. Shtojca 14 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore për verifikimin e njehsorëve të energjisë elektrike;
- 1.15. Shtojca 15 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore, për verifikimin e transformatorëve matës;
- 1.16. Shtojca 16 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore të cilat përdoren për verifikimin e instalimeve elektrike;
- 1.17. Shtojca 17 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore te pajisjeve për matjen e nivelit të alkoolit etilik në frymëmarrjen e të anketuarve;
- 1.18. Shtojca 18 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore- taksimetrave;
- 1.19. Shtojca 19 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore për matjen e shpejtësisë në trafikun rrugor;
- 1.20. Shtojca 20 Për verifikimin e mjeteve matëse në qendrat e kontrollimit teknik të automjeteve;
- 1.21. Shtojca 21 Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore – Tahograf dhe kufizuesi i shpejtësisë.
- 1.22. Shtojca 22. Për kontrollimin e produkteve për parapaketimet.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Rozeta Hajdari

Ministër

04.07.2024

SHTOJCA 1

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERESIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE TË GJATËSISË DHE KËNDIT

Kërkesat e veçanta nga kjo shtojcë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me rekomandimet në fuqi të Organizatës ndërkombëtare për metrologji ligjore (International Organization of Legal Metrology): OIML R 35-1, OIML R 35-2, OIML R 35-3 dhe OIML R 66.

1. ETALONËT DHE PAJISJET

1.1. Etalonët për verifikimin e mjeteve matëse mund të jenë:

- shiriti matës,
- vizorja matëse.

Pasiguria matëse e shiritit matës të dhe vizores matëse të duhet të jetë së paku dy herë më e vogël se sa gabimi më i madhe i lejuar i mjetit matës të gjatësisë.

1.2. Pajisjet për verifikimin e mjeteve matëse mund të jenë:

- pajisja për verifikimin e mjetit matës të gjatësisë me shiritin matës, ku pasiguria relative matëse e pajisjes për verifikimin e mjetit matës së gjatësisë me shirit matës nuk guxon të jetë më e madhe se $\pm 0.01\%$
- pajisja për verifikimin e mjeteve matëse të ngurta të gjatësisë, ku pasiguria relative matëse e pajisjes për verifikimin e mjeteve matëse të ngurta të gjatësisë nuk guxon të jetë më e madhe se $\pm 0.01\%$
- pajisja për verifikimin e mjeteve matëse të gjerësisë dhe lartësisë së binarëve, pasiguria matëse e pajisjes për verifikimin e mjeteve matëse të gjerësisë dhe lartësisë së binarëve duhet të jetë së paku dy herë më e vogël se sa gabimi më i madh i lejuar i mjetit matës të gjatësisë.

1.3. Pajisjet ndihmëse që përdoren në verifikimin e mjeteve matëse përbëhen nga:

- Nivelizuesi (libela) për sjelljen e pajisjeve për verifikimin e mjeteve matëse dhe mjeteve matëse në pozitë horizontale, ndjeshmëria e nivelizuesit për sjelljen e pajisjeve për verifikimin e mjeteve matëse në pozitë horizontale duhet të jetë së paku 0,01 mm/m
- bartësi (transportuesi), stoli dhe mbajtësi i mjetit matës dhe etalonit - stoli dhe mbajtësi i mjetit matës dhe etalonit mund të jenë të punuar në mënyra të ndryshme, por duhet të mundësojnë vendosjen e etalonit ose mjetit matës në pozitë të duhur, me kushte që të arrihen rezultate më të besueshme të matjes
- mjetet për heqjen e yndyrës dhe pastrimin e etalonëve dhe mjeteve matëse; mjetet për heqjen e yndyrës nga etalonët mund të jenë alkooli ose benzina e lehtë, kurse mjete për pastrim mund të jenë leckë e butë, furça me qime të buta e të ngjashme
- mjetet për mbrojtjen e sipërfaqeve matëse të etalonit dhe mjeteve matëse; mjetet për mbrojtjen e sipërfaqeve matëse të etalonit dhe mjeteve matëse mund të jenë yndyra e vazelinës ose vaji
- mjetet ndihmëse që janë pjesë përbërëse të pajisjes për verifikimin e mjetit matës, që është karakteristik për çdo pajisje që varet nga qëllimi i saj.

- 1.4. Termometri me ndarje 0.1 °C për matjen e temperaturës së ajrit të mjedisit të punës.
- 1.5. Hygrometri me ndarje 0.1 % për matjen e lagështisë relative të ajrit të mjedisit të punës.
- Etalonët dhe pajisjet nën pikën 1.1.; 1.2.; Nivelizuesi nga pika 1.3.;1.4 dhe 1.5., duhet të jenë të kalibruara,

2. HAPËSIRAT DHE KUSHTET

2.1. Trupi i emëruar duhet të ketë hapësirë të punës e cila i plotëson kushtet e mëposhtme:

- të jetë i pastër, i thatë dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme për verifikimin të papenguar
- të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve të nevojshme
- të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit
- të jetë e pajisur me orendi për vendosjen e mjeteve matëse për verifikim
- në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjes,
- në hapësirë duhet të ketë termometër për matjen e temperaturës së ajrit,
- në hapësirë duhet të ketë hygrometër për matjen e lagështisë relative të ajrit,
- të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës dhe sipas nevojës edhe me kondicioner ajri.

2.2. Temperatura e ambientit të punës në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 18°C deri 22°C.

2.3. Lagështia relative e ajrit në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 50% deri 60%.

2.4. Termometri dhe hygrometri duhet të jenë të vendosur në murin e hapësirës ashtu që nga muri të jenë larg 10 cm deri 15 cm, dhe lartësi 150 cm deri 170 cm nga dyshemeja.

2.5. Burimet e ngrohjes së hapësirës duhet të jenë së paku 1,5 m larg pajisjeve, gjegjësisht nga vendi ku kryhet verifikimi dhe duhet të mundësojnë ngrohjen e njëtrajtshme të hapësirës.

SHTOJCA 2

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE AUTOMATIKE TË NIVELIT TË LËNGJEVE NË REZERVUARËT (ENËT) E PALËVIZSHËM (AMR)

Kërkesat e veçanta nga kjo Shtojcë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me rekomandimet në fuqi të Organizatës ndërkombëtare për metrologji ligjore (International Organization of Legal Metrology): OIML R 85-1-2 dhe OIML R 85-3.

1. ETALONËT DHE PAJISJET

1.1. Verifikimi në laborator:

1.1.1. Ena (kupë) testuese e mbushur me lëngun testues.

1.1.2. Programi matës për kontrollim automatik të saktësisë, ndjeshmërisë dhe histerezës gjegjësisht dirigjimi adekuat me dorë për rregullimin e nivelit të lëngut testues.

1.1.3. Interferometri laserik me optikë lineare dhe mbështetje programore të kompensimit për matjen e lartësisë reale të nivelit.

1.1.4. Matësi i temperaturës me shkallëzim prej 0,1 °C dhe saktësi prej $\pm 0,5^{\circ}\text{C}$.

1.1.5. Matësi i shtypjes së ajrit.

1.1.6. Matësi lëvizës (shubleri).

1.2. Verifikimi në vendngjarje:

1.2.1. Shufra matëse (shiriti matës).

1.2.2. Termometri me ndarje 0,1 °C për matjen e temperaturës së ajrit në ambientin e punës.

1.2.3 Hygrometer me ndarje 0.1 % për matjen e lagështisë së ajrit në ambientin e punës

1.2.4. Laptop me mbështetje programore të instaluar për verifikimin e versioneve programore të stacionit matës.

Etalonët nën pikën 1.1. dhe 1.2. duhet të jenë kalibruar.

2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirë të punës kur kryhet verifikimi në laborator e cila duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të jetë e pastër, i thatë dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme për verifikim të papenguar;
- të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve të nevojshme;
- të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit;
- të jetë e pajisur me orendi për vendosjen e mjeteve matëse që verifikohen;
- të ketë ndriçim natyral dhe ndriçim elektrik;
- në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjes;
- në hapësirë duhet të ketë termometër për matjen e temperaturës së ajrit;
- në hapësirë duhet të ketë hygrometër për matjen e lagështisë relative të ajrit;
- të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës dhe sipas nevojës edhe kondicioner ajri.

2.2. Temperatura ambientit të punës në hapësirën e punës (laborator) duhet të jetë në kufijtë prej 18 °C deri 25 °C.

2.3. Lagështia relative e ajrit në hapësirën e punës (laborator) duhet të jetë në kufijtë prej 50% deri 60%.

2.4. Termometrat dhe hygrometrat duhet të jenë të vendosur në murin e hapësirës ashtu që nga muri të jenë larg 10 cm deri 15 cm, dhe lartësi 150 cm deri 170 cm nga dyshemeja.

2.5. Burimet e ngrohjes së hapësirës duhet të jenë së paku 1,5 m larg pajisjeve, gjegjësisht nga vendi ku kryhet verifikimi dhe duhet ta mundësojnë ngrohjen e njëtrajtshme të hapësirës.

SHTOJCA 3

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE PËR REZERVUARËT CILINDRIKË HORIZONTALË DHE VERTIKALË

Kërkesat e veçanta nga kjo Shtojcë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me rekomandimet në fuqi të Organizatës ndërkombëtare për metrologji ligjore (International Organization of Legal Metrology): OIML R 71, OIML R 80.1, OIML R 95 dhe OIML R 125.

Rezervuarët (enët) në kuptim të kësaj shtojce kategorizohen në këto metoda të matjes:

1. Rezervuarët cilindrikë vertikalë nëse matja kryhet me metodën e trekëndëzimit optik;
2. Rezervuarët cilindrikë vertikalë nëse matja kryhet me metodën e linjës referuese optike
3. Rezervuarët cilindrikë vertikalë nëse matja kryhet me metodën e brezit
4. Rezervuarët cilindrikë vertikalë nëse matja kryhet me metodën e matjes së distancës së brendshme elektro optike
5. Rezervuarët cilindrikë horizontalë.

1. Rezervuarët cilindrikë vertikalë nëse matja kryhet me metodën e trekëndëzimit optik

1.1. ETALONËT DHE PAJISJET

1.1.1. Teodoliti elektronik, saktësia 2×10^{-4} [g] gradë.

1.1.2. Programi i validuar për punimin e tabelës së vëllimit.

1.1.3. Shiriti matës prej 25 m.

1.1.4. Matësi i thellësisë prej 25 m.

1.1.5. Termometri me ndarje 0,2 °C.

1.1.6. Termometri kontaktues me ndarje prej 0,2 °C.

1.1.7. Pajisjet laserike për teodolite.

1.1.8. Matësi me ultrazë i trashësisë së murit.

1.1.9. Matësi i rrjedhës, pasiguria maksimale matëse 0,2%.

1.1.10. Pajisjet ndihmëse duhet të jetë sipas udhëzimeve të prodhuesit të mjetit matës.

Etalonët dhe pajisjet matëse duhet të jenë të kalibruar.

1.2. HAPËSIRAT DHE KUSHTET

Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirë për punë në zyrë, hapësirë të mjaftueshme për etalonët dhe pajisjet, gjithashtu edhe hapësirë për ruajtje të sigurte të dokumentacionit.

2. Rezervuarët cilindrikë vertikalë nëse matja kryhet me metodën e linjës referuese optike

2.1. ETALONËT DHE PAJISJET

2.1.1. Pajisja për matjen e devijimit vertikal.

2.1.2. Programi i validuar për punimin e tabelës së vëllimit.

2.1.3. Shiriti matës prej 25 m.

2.1.4. Matësi i thellësisë prej 25 m.

- 2.1.5. Termometri me ndarje 0,2 °C.
 - 2.1.6. Termometri kontaktues me ndarje prej 0,2 °C.
 - 2.1.7. Pajisjet laserike për teodolitet.
 - 2.1.8. Matësi me ultrazë i trashësisë së murit.
 - 2.1.9. Matësi i rrjedhjes, pasiguria maksimale matëse 0,2%.
 - 2.1.10. Pajisjet ndihmëse duhet të jetë sipas udhëzimeve të prodhuesit të mjetit matës.
- Etalonët dhe pajisjet matëse duhet të jenë të kalibruar.

2.2. HAPËSIRAT DHE KUSHTET

Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirë për punë në zyrë, hapësirë të mjaftueshme për etalonët dhe pajisjet, gjithashtu edhe hapësirë për ruajtje të dokumentacionit.

3. Rezervuarët cilindrikë vertikalë nëse matja kryhet me metodën e brezit

3.1. ETALONËT DHE PAJISJET

- 3.1.1. Programi i validuar për krijimin e tabelës së vëllimit.
- 3.1.2. Shiriti matës prej 25 m.
- 3.1.3. Matësi i thellësisë prej 25 m.
- 3.1.4. Peshorja me spirale.
- 3.1.5. »Step-over«.
- 3.1.6. Rregulluesi i shiritit.
- 3.1.7. Termometri me ndarje 0,2 °C.
- 3.1.8. Termometri kontaktues me ndarje prej 0,2 °C.
- 3.1.9. Matësi me ultrazë i trashësisë së murit.
- 3.1.10. Matësi i rrjedhjes, pasiguria maksimale matëse 0,2%.
- 3.1.11. Pajisjet ndihmëse duhet të jenë sipas udhëzimeve të prodhuesit të mjetit matës, si pajisje ndihmëse është skela për matjen e perimetrit të rezervuarit.
- 3.1.12. Etalonët dhe pajisjet matëse duhet të jenë të kalibruar.

3.2. HAPËSIRAT DHE KUSHTET

Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirë për punë në zyrë, hapësirë të mjaftueshme për etalonët dhe pajisjet, gjithashtu edhe hapësirë për ruajtje të dokumentacionit.

4. Rezervuarët cilindrikë vertikalë nëse matja kryhet me metodën e matjes së distancës së brendshme elektro optike.

4.1. ETALONËT DHE PAJISJET

- 4.1.1. Programi i validuar për punimin e tabelës së vëllimit.
- 4.1.2. Mjeti matës EODR (elektro-optical distance ranging instrument), saktësia 10^{-4} [g] gradë .
- 4.1.3. Pajisjet laserike – duhet të jenë në përputhje me IEC 825 dhe mund të jenë pjesë përbërëse e mjetit matës EODR.
- 4.1.4. Shufra standarde – duhet të jetë me gjatësi 2 metra dhe nuk e ndryshon gjatësinë më shumë se ± 0.02 mm.
- 4.1.5. Shiriti matës prej 25 m.

- 4.1.6. Matësi i thellësisë prej 25 m.
- 4.1.7. Termometri me ndarje 0,2 °C.
- 4.1.8. Termometri kontaktues me ndarje prej 0,2 °C.
- 4.1.9. Matësi me ultrazë i trashësisë së murit.
- 4.1.10. Matësi i rrjedhjes, pasiguria maksimale matëse 0,2%.
- 4.1.11. Pajisjet ndihmëse duhet të jenë sipas udhëzimeve të prodhuesit të mjetit matës.
- 4.1.12. Etalonët dhe pajisjet matëse duhet të jenë të kalibruar.

4.2. HAPËSIRAT DHE KUSHTET

Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirë për punë në zyrë, hapësirë të mjaftueshme për etalonët dhe pajisjet, gjithashtu edhe hapësirë për ruajtje të dokumentacionit.

5. Rezervuarët cilindrikë horizontalë

5.1. ETALONËT DHE PAJISJET

- 5.1.1. Ekstensiometri.
- 5.1.2. Program i validuar për punimin e tabelës së vëllimit.
- 5.1.3. Shiriti matës prej 25 m.
- 5.1.4. Shiriti matës prej 2 m apo më tepër.
- 5.1.5. Shufra matëse 3 m, me ndarje milimetrike.
- 5.1.6. Nivelizuesi (Libela) ose lavjerrësi ose teodoliti me shufer standarde.
- 5.1.7. Termometri me ndarje 0,2 °C.
- 5.1.8. Matësi i rrjedhës, pasiguria maksimale matëse 0,2%.
- 5.1.9. Pajisjet ndihmëse duhet të jenë sipas udhëzimeve të prodhuesve të pajisjeve matëse.
- 5.1.10 Etalonët dhe mjetet matëse duhet të jenë të kalibruara.

5.2. HAPËSIRAT DHE KUSHTET

Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirë për punë në zyrë, hapësirë të mjaftueshme për etalonët dhe pajisjet, gjithashtu edhe hapësirë për ruajtje të dokumentacionit.

SHTOJCA 4

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE UJËMATËSVE DHE/OSE MJETEVE MATËSE TË RRJEDHJES SË UJIT

Kërkesat e veçanta nga kjo Shtojcë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me rekomandimet në fuqi të Organizatës ndërkombëtare për metrologji ligjore (International Organization of Legal Metrology): OIML R 49-1, OIML R 49-2 dhe OIML R 49-3.

Për qëllimet të kësaj Shtojce mjetet matëse ndahen në këto kategori:

1. Ujëmatësit
2. Mjetet matëse të rrjedhjes së ujit.

1. Ujëmatësit

1.1 ETALONËT DHE PAJISJET

1.1.1. Pajisja për verifikimin e ujëmatësve, me pajisjet kontrolluese shoqëruese siç janë: manometri, termometri, matësi i rrjedhës, peshorja, ena matëse etj.

1.1.2. Manometri për matjen e presionit të ujit në hyrjen e linjës verifikuese, me gabim të lejuar maksimal $\pm 5\%$.

1.1.3. Ngrohësit që ngrohin ujin deri në temperaturën e punës minimum $60\text{ }^{\circ}\text{C}$ (nëse verifikohet ujëmatësit për ujë të ngrohtë).

1.1.4. Termometri me ndarje $0.1\text{ }^{\circ}\text{C}$ për matjen e temperaturës së ambientet te punës.

Etalonët dhe pajisjet nga pika 1.1.1. 1.1.2. dhe 1.1.4 duhet të jenë të kalibruara.

1.1.5. Pajisja për verifikimin e ujëmatësit duhet ta mundësojë verifikimin e ujëmatësit me metodën volumetrike ose gravimetrike.

1.1.6. Pajisja për verifikimin e ujëmatësit duhet t'i ketë këto veçori metrologjike:

– gabimi maksimal i lejuar i matjes së vëllimit të ujit, që gjatë verifikimit kalon nëpër ujëmatës, nuk guxon të jetë më i madh se një e pesta ($1/5$) e gabimit maksimal të lejuar të ujëmatësit të testuar.

– gabimi maksimal i lejuar së presionit të ujit gjatë verifikimit nuk duhet të jete më e madhe se $\pm 10\%$

– Pasiguria maksimale e presionit së ujit nuk duhet të jete me e madhe se $\pm 5\%$ e vlerës së matur.

– Pasiguria maksimale e temperaturës së ujit nuk duhet të jetë me e madhe se $\pm 1^{\circ}\text{C}$.

1.1.7. Pajisja për verifikimin e ujëmatësit mund të jetë automatike, me linja të ndryshme të parakaluese, valvule, kufizues të rrjedhës e ngjashëm, kështu që:

- ndryshimet e shtypjes së ujit gjatë kohës verifikimit të ujëmatësit nuk duhet të jenë me te madha se:

a) 5% për rrjedha $Q_{\min} \leq Q < Q_t$, dhe për $Q_1 \leq Q < Q_2$

b) 10% për rrjedha $Q_t \leq Q < Q_{\max}$ dhe për $Q_2 \leq Q < Q_3$

- ndryshimet e rrjedhjes së ujit gjatë kohës së verifikimit të ujëmatësit nuk duhet të jenë më të madha se:

a) 2,5% për rrjedhjet $Q_{min} \leq Q < Q_t$, dhe për $Q_1 \leq Q < Q_2$

b) 5% për rrjedhjet $Q_t \leq Q < Q_{max}$ dhe për $Q_2 \leq Q < Q_3$

– ndryshimet e temperaturës së ujit gjatë kohës së verifikimit të ujëmatësit nuk duhet të jetë më i madh se $\pm 5^\circ\text{C}$

– temperatura e ujit gjatë kohës së verifikimit të ujëmatësit është në kufijtë:

a) $(20 \pm 5)^\circ\text{C}$, për verifikimit e ujëmatësit për ujë të ftohtë.

b) $(50 \pm 5)^\circ\text{C}$, për verifikimit e ujëmatësit për ujë të ngrohtë.

– Presioni e ujit në hyrje të ujëmatësit, gjatë kohës së verifikimit të ujëmatësit, nuk është më i lartë se shtypja e lejuar punuese për llojin e verifikuar të ujëmatësit.

– Presioni i ujit, në dalje të ujëmatësit, gjatë kohës së verifikimit të ujëmatësit, nuk duhet të jetë më i ulët se 0,03 MPa (0,3 bar)

1.1.8. Mundëson verifikimin veç e veç të ujëmatëseve apo verifikimin në varg:

- mund të paraqiten veçoritë e se cilit ujëmatës

- nuk ka ndërveprime të ujëmatësve

- shtypja e ujit në dalje të çdo ujëmatësi është mjaftueshëm e lartë për ta parandaluar shfaqjen e kavitacionit.

1.1.9. Çdo cikël verifikuese i ujëmatësit mund të jetë i mbikëqyrur.

1.1.10. Në çdo moment gjatë verifikimit të ujëmatësit mund të matet, përkatësisht të mbikëqyret humbja e brendshme e presionit.

1.1.11. Në çdo moment gjatë verifikimit të ujëmatësit, janë plotësuar kërkesat e punës që i përcakton prodhuesi i ujëmatësit që testohet.

1.1.12. Siguron që gjatë verifikimit të ujëmatësit nuk ka ajër në sistemin verifikuese

1.1.13. Nëse ena matëse e pajisjes për verifikimin e ujëmatësit është e ndarë në disa dhomëza, muret ndarëse duhet të jenë mjaftueshëm të forta për të siguruar që vëllimi i dhomëzës mos të ndryshoj më shumë se 0,5%, varësisht prej asaj nëse dhomëzat fqinje janë të plota apo të zbrazëta

1.1.14. Sistemi testues plotëson kërkesat tjera teknike të prodhuesit të mjetit matës, i cili është përfshirë në sistemin verifikues të pajisjes për verifikimin e ujëmatësit.

1.2. HAPËSIRAT DHE KUSHTET

1.2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet t'i ketë hapësirat punuese që duhet t'i plotësojnë këto kushte:

– të jenë të pastra, të thata dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme për verifikimin e papenguar të mjeteve matëse

– të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen pajisjeve të nevojshme

– të jenë të mbrojtura nga ekspozimi direkt i rrezeve të diellit

– të ketë orendi për vendosjen e mjetit matës që verifikohet

– të ketë ndriçim natyral si dhe ndriçim elektrik

– në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjeve

– në hapësirë duhet të ketë termometër kontrollues për matjen e temperaturës së ajrit, të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës punuese dhe sipas nevojës edhe me kondicioner ajri

1.2.2. Temperatura e ambientit të punës në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 15 °C deri në 25 °C.

1.2.3. Lagështia relative e ambientit në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 45% deri 75%.

1.2.4. Presioni në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 860 mbar deri 1060 mbar.

1.2.5. Termometri për matjen e temperaturës së ajrit të ambientit të punës duhet të jetë i vendosur në mur të hapësirës për verifikimin e ujëmatësit ashtu që muri të jetë larg 10 cm deri në 15 cm, dhe lartësi 1,5 m dhe 1,7 m nga dyshemeja.

1.2.6. Burimet e ngrohjes së hapësirës për verifikimin e ujëmatësve duhet të jenë së paku 1,5 m larg pajisjeve, gjegjësisht nga vendi ku kryhet verifikimi i ujëmatësit dhe duhet të mundësojnë ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës për verifikimin e mjeteve matëse.

1.2.7. Muret e hapësirës për verifikim duhet të jenë të mbuluar me pllaka të qeramikës apo të lyhen me ngjyrë vaji në lartësi së paku 1,5 m nga dyshemeja.

1.2.8. Dyshemeja e hapësirës për verifikim duhet të jetë e shtruar me pllaka të qeramikës apo me dysheme jo të rrëshqitshme me rënie drejt vrimës për largimin e ujërave të zeza.

1.2.9. Në dysheme të hapësirës për verifikim, rreth pajisjes për verifikimin e ujëmatësve, duhet të ketë grila druri apo shtrojë gome me vrima, nëse gjatë verifikimit të ujëmatësve vjen deri tek derdhja e ujit mbi dysheme.

1.2.10. Në hapësirën për verifikim mund të jetë cilido sistem i furnizimit me ujë, por nëse bëhen disa cikle verifikime të ujëmatësve, nuk guxon të ketë pengesa që do të jenë në kundërshtim me kërkesat e parapara në pikën 1.1. dhe kërkesat teknike të prodhuesit të pajisjes për verifikim e ujëmatësve.

1.2.11. Sistemi i furnizimit me ujë duhet të jetë i atillë që mos të ketë luhatje të shtypjes së ujit gjatë futjes së ujit në pajisjen për verifikimin e ujëmatësve.

1.2.12. Futja e ujit në enën matëse të pajisjes për verifikimin e ujëmatësit duhet të jetë e atillë ashtu që uji të jetë në gjendje të qetë.

1.2.13. Largimi i ujit duhet të jetë i atillë që mundet njëkohësisht ta pranojë gjithë sasinë e ujit nga ena matëse, pa e bllokuar apo ngadalësuar largimin.

1.2.14 Hapësirë për ruajtje të dokumentacionit

2. Mjetet matëse rrjedhëse së ujit

2.1. ETALONËT DHE PAJISJET

2.1.1. Etalonët që mund të përdoren:

– Ena matëse e etalonëve me vëllimin më të vogël që mundëson verifikimin e rrjedhës një minutëshe për rrjedhën maksimale të mjetit matës së rrjedhës së ujit – pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,05\%$

– Gypi lakues referent (prover)- pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,03\%$

– Gypi standard me piston (compact prover) – pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,03\%$

– Mjeti matës krahasues (master metër) pasiguria maksimale e të cilit është $\pm 0,1 \%$, që mundëson verifikimin e rrjedhjes minimale dhe maksimale të mjetit matës të rrjedhjes së ujit.

2.1.2. Termometri ndarja e të cilit nuk duhet të jenë më të mëdha se $0,1 \text{ }^\circ\text{C}$.

2.1.3. Kronometri (Sekondmatës).

2.1.4. Etalonët dhe pajisjet duhet të jenë të kalibruara.

2.2. HAPËSIRAT DHE KUSHTET

2.2.1 Trupi për vlerësim të konformitetit duhet ta ketë hapësirën e punës që duhet t'i plotësojë këto kushte:

- të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve
- të jenë të mbrojtura nga ekspozimi direkt i rrezeve të diellit
- të ketë orendi për vendosjen e dokumentacionit
- të ketë ndriçim natyral dhe si dhe ndriçim elektrik
- duhet të ketë hapësirë për punën në zyrë.

SHTOJCA 5

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE TË ENERGJISË TERMIKE

Kërkesat e veçanta nga kjo Shtojcë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me rekomandimet në fuqi të Organizatës ndërkombëtare për metrologji ligjore (International Organization of Legal Metrology): OIML R 75-1, OIML R 75-2 dhe OIML R 75-3.

1. ETALONËT DHE PAJISJET

1.1. Pajisjet e nevojshme për verifikimin e mjeteve matëse të energjisë termike:

– tavolina matëse për verifikim me matës të integruar për matjen e energjisë termike, apo të mjeteve matëse të rrjedhjes si nëngrup i mjeteve matëse të energjisë termike, me ujë me temperaturë $(50 \pm 5) ^\circ\text{C}$

– peshorja me enën përkatëse për përcaktimin e vëllimit (apo masës) i cili kalon nëpër mjetet matëse të rrjedhës që testohen.

1.2. Saktësia e etalonëve duhet të sigurojë që gabimi në procesin e matjes të jetë i barabartë ose më i ulët se $1/3$ e vlerës së gabimit maksimal të lejuar të mjetit matës që testohet.

1.3. Aplikimi i peshores ndërlihet me vendin ku është e vendosur peshorja dhe vlen vetëm në kërkesat që janë përcaktuar në kalibrim. Periudha e kalibrimit për peshoren është një vit.

1.4. Në peshore duhet të jetë të shënuara madhësia minimale dhe maksimale e peshimit, e cila konfirmohet me rastin e miratimit të vendit të verifikimit.

1.5. Madhësia minimale e lejuar e peshimit është 5 kg. Midis madhësisë minimale të peshimit m_{\min} dhe madhësisë maksimale të peshimit m_{\max} , gabimi nuk duhet ta kalojë vlerën e më poshtme:

$$P_{\text{dop}} = \pm [10 + 0,2(m - 5)].$$

- m , është masa e peshimit në kg,

- P_{dop} , është gabimi i lejuar në g.

1.6. Ena e peshores duhet të jetë e ndërtuar në atë mënyrë që sasia e mbajtësit të nxehtësisë që avullohet gjatë verifikimit nuk kalon $1/5$ të gabimit të lejuar nga sasia përkatëse e peshimit.

1.7. Peshat duhet të jenë të klasës gjegjëse të saktësisë, me të cilat mund të vërtetohet që saktësia e peshores është brenda kufijve të lejuar të gabimeve.

1.8. Banjat me temperaturë të rregulluar duhet të punohen ashtu që në diapazonin e temperaturës mes $40 ^\circ\text{C}$ dhe $130 ^\circ\text{C}$, brenda fushës së verifikimit, pas arritjes së temperaturës së duhur, luhatjet e temperaturës nuk duhet të jenë më të larta se $\pm 0,02$ K. Thellësia e hapësirës punuese të banjës duhet të jetë e barabartë apo më e madhe se 200 mm.

1.9. Termometri rezistues nga platini për matjen e temperaturës së banjave me temperaturë të rregulluar duhet të jenë të konstruktuar ashtu që gabimet e matjes të jenë të barabarta apo më të vogla se $\pm 0,02$ K dhe ndryshimi e treguar në diapazonin e temperaturës mes $40 ^\circ\text{C}$ dhe $130 ^\circ\text{C}$ mos të jetë më i lartë se $\pm 0,02$ K në vit. Termometrat rezistues nga platini duhet kalibruar çdo dy vjet.

1.10. Sistemi për verifikimin e njësisë llogaritëse si nëngrup i mjeteve matëse të energjisë termike.

1.11. Rezistuesit testues të etalonëve duhet të jenë të kalibruar çdo dy vjet. Koeficienti i temperaturës së rezistuesve testues të etalonëve nuk duhet të jetë më i lartë se ± 1 ppm/K. Ndryshimi i rezistencës së rezistuesve nuk duhet të jetë më i madh se ± 10 ppm/për vit.

1.12. Pajisjet e kalibruara për përcjelljen e kushteve të ambientit të punës me mundësi regjistrimi të të dhënave (termometri për matjen e temperaturës së ajrit me ndarje prej 0.1 °C).

1.13. Për matjen e vëllimit të ujit të ngrohtë me qëllim të verifikimit, peshorja guxon të zëvendësohet me mjete krahasuese matëse të rrjedhjes (apo me disa mjete krahasuese matëse të rrjedhjes), nëse ky mjet matës është i konstruktuar ashtu që ndryshimi i prituri i gabimeve të matjes së vëllimit në tërë diapazonin e matjes nuk është më i madh se $\pm 0,2$ % në vit, dhe nëse saktësia e mjeteve krahasuese matëse të rrjedhjes verifikohet me ndihmën e peshores se paku një herë në muaj dhe për këtë të mbahen shënime. Diapazonet e matjes së mjetit krahasues matës së rrjedhjes (apo mjeteve krahasuese matëse) përcaktohen në raportin mbi miratimin e vendit testues.

1.14. Etalonët për përcaktimin e vëllimit të ujit të ngrohtë që rrjedh nëpër mjetet testuese matëse dhe për mbikëqyrje të mjetit krahasues matës të rrjedhjes mund të jenë vetëm peshoret, që janë të lidhura me termometrat për korrigjimin e dendësisë dhe koeficientit termik. Subjekti i autorizuar mundet për këtë qëllim mund ta përdorë një apo më shumë peshore.

1.15 Etalonët në piken 1.1 me pajisjet përcjellëse duhet të jenë të kalibruara.

2. HAPËSIRAT DHE KUSHTET

2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet ta ketë hapësirën punuese që duhet t'i plotësojë këto kushte:

- të jenë të pastra, të thata dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme për verifikim të papenguar të mjeteve matëse
- të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve
- të jenë të mbrojtura nga ekspozimi direkt i rrezeve të diellit
- në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjeve
- të ketë orendi për vendosjen e mjeteve matëse që testohen
- të ketë hapësirë për ruajtjen e dokumentacionit
- në hapësirat punuese duhet të jetë i vendosur pajisja për përcjelljen e kushteve të ambientit të punës.
- të ketë ndriçim natyral si dhe ndriçim elektrik
- të jenë të pajisura me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës, dhe sipas nevojës me kondicioner ajri.

2.2. Temperatura e ambientit të punës në hapësirat punuese duhet të jetë në kufijtë prej 20 °C deri në 25 °C.

2.3. Burimet e ngrohjes së hapësirës për verifikimin e mjeteve matëse të energjisë termike duhet të jenë së paku $1,5$ m larg pajisjeve, gjegjësisht nga vendi ku bëhen verifikimet e mjeteve matëse dhe duhet të mundësojnë ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës për verifikimin e mjeteve matëse të energjisë termike.

SHTOJCA 6

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE DHE SISTEMEVE MATËSE LIGJORE PËR MATJEN E SASISË SË LËNGJEVE TË NDRYSHME NGA UJI

Kërkesat e veçanta nga kjo Shtojcë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me rekomandimet në fuqi të Organizatës ndërkombëtare për metrologji ligjore (International Organization of Legal Metrology): OIML R 81, OIML R 117, OIML R 120.

Mjetet dhe sistemet matëse për matjen e sasive të lëngjeve të ndryshme nga uji kategorizohen në këto fusha:

1. Mjetet për matjen e vëllimit të alkoolit, pijeve joalkoolike, birrës, qumështit.
2. Agregatet për mbushjen e mjeteve motorike me karburante
3. Agregatet për mbushjen e mjeteve motorike me GLN
4. Sistemet matëse në autocisterna për qumësht dhe artikuj tjerë në industrinë ushqimore
5. Sistemet matëse në autocisterna për karburante, në vendet për ngarkim të autocisternave, cisternë-vagonëve dhe cisternave në anije.
6. Sistemet matëse në autocisterna dhe sistemet matëse të palevizshme për GLN
7. Mjetet matëse të vëllimit që nuk gjendet në sistemin matës
8. Kompenzatorët e temperaturës.

1. Mjetet për matjen e vëllimit të alkoolit, pijeve joalkoolike, birrës, qumështit

1.1. ETALONËT DHE PAJISJET

1.1.1. Për verifikimin e mjeteve matëse mund të përdoret:

- ena matëse e etalonit me vëllimin më të vogël që mundëson verifikimin e rrjedhës një minutëshe për rrjedhjen maksimale të sistemit matës – pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,05\%$
- gypi lakues referent (prover)- pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,03\%$
- gypi standard me piston (compact prover) – pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,03\%$
- mjeti matës krahasues (master metër) me enë me vëllim minimal që mundëson verifikimin rrjedhës një minutëshe për rrjedhën maksimale të sistemit matës – pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,1\%$.

1.1.2. Termometri ndarjet e të cilit nuk duhet të jenë më të mëdha se $0,1\text{ }^{\circ}\text{C}$.

1.1.3. Kronometri (Sekondmatës).

Etalonët nga pika 1.1.1. dhe 1.1.2; duhet të jenë të kalibruar

1.2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

1.2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirën për punë në zyrë, për ruajtje të etalonëve dhe dokumentacionit:

1.2.2. Temperatura e ambientit të punës gjatë verifikimit duhet të jetë në kufijtë prej $0\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri në $35\text{ }^{\circ}\text{C}$.

2. Agregatet për mbushjen e mjeteve motorike me karburante

2.1. ETALONËT DHE PAJISJET

2.1.1. Enët matëse standarde prej 5 litra, 10 litra, 20 litra, 50 litra, dhe 100 litra për rrjedhat deri në 100 litra/min – pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,05\%$.

2.1.2. Termometri ndarjet e të cilit nuk duhet të jenë më të mëdha se $0,1\text{ }^\circ\text{C}$.

2.1.3. Kronometri (Sekondmatës).

Etalonët nga pika 2.1.1. dhe 2.1.2 duhet të jenë të kalibruar.

2.2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

2.2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirën për punë në zyrë, për ruajtje të etalonëve dhe dokumentacionit:

2.2.2. Temperatura e ambientit të punës gjatë kohës së verifikimit mjeteve matëse për rrjedhje duhet të jetë në kufijtë prej $0\text{ }^\circ\text{C}$ deri në $35\text{ }^\circ\text{C}$.

3. Agregatet për mbushjen e mjeteve motorike me GLN

3.1. ETALONËT DHE PAJISJET

3.1.1. Për verifikimin e mjeteve matëse që mund të përdoren:

–enët matëse prej së paku 20 litra me pajisjen për zbrazjen e enës së etalonit– pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,1\%$

– mjeti matës krahasues (master metër) me enë me vëllim minimal që mundëson verifikimin rrjedhës një minutëshe për rrjedhën maksimale agregatit për mbushje me GLN – pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,2\%$.

-Mjeti matës krahasues (master metër) me mundësi të rregullimit të rrjedhjeve sipas të cilave verifikohet mjeti matës i rrjedhjes, me pasiguri maksimale $\pm 0,2\%$

3.1.2. Termometri ndarjet e të cilit nuk duhet të jenë më të mëdha se $0,1\text{ }^\circ\text{C}$.

3.1.3. Kronometri (Sekondmatës).

3.1.4. Etalonët nga pika 3.1.1. duhet të jenë të kalibruar

3.2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

3.2.1. Trupi i emëruar duhet të ketë hapësirë për punë në zyrë, për ruajtje të etalonëve dhe dokumentacionit;

3.2.2. Temperatura e ambientit gjatë kohës së verifikimit mjeteve matëse rrjedhëse duhet të jetë në kufijtë prej $0\text{ }^\circ\text{C}$ deri në $35\text{ }^\circ\text{C}$.

4. Sistemet matëse në autocisterna dhe sistemet e qëndrueshme matëse për qumësht dhe artikuj tjerë në industrinë ushqimore

4.1. ETALONËT DHE PAJISJET

4.1.1. Për verifikimin e mjeteve matëse mund të përdoren:

– enët matëse të vëllimit minimal që mundësojnë verifikimin e rrjedhës një minutëshe për vëllim maksimal të sistemit matës me pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,05\%$

– gypi i lakuar referent (prover) apo gypi i standard me piston (compact prover) – pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,03\%$

– mjeti krahasues matës (master metër) që mundëson verifikimin e rrjedhës një minutëshe për rrjedhën maksimale të sistemit matës – pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,1$ %.

4.1.2. Termometri ndarjet e të cilit nuk duhet të jenë më të mëdha se $0,2$ °C.

4.1.3. Kronometri (Sekondmatës).

4.1.4. Etalonët nga pika 4.1.1. duhet të jenë të kalibruar.

4.2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

4.2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësira për punë në zyrë, për ruajtje të etalonëve dhe dokumentacionit:

4.2.2. Temperatura e ambientit gjatë kohës së verifikimit të mjeteve matëse të rrjedhjes duhet të jetë në kufijtë prej 0 °C deri në 35 °C.

5. Sistemet matëse në autocisterna për karburante dhe në vendet për ngarkim në autocisterna, cisternë- vagonë dhe cisterna në lundruese

5.1. ETALONËT DHE PAJISJET

5.1.1. Për verifikimin e mjeteve matëse mund të përdoren:

– një apo më shumë enë matëse të etalonit të vëllimit minimal që mundësojnë verifikimin e rrjedhës një minutëshe për vëllim maksimal të sistemit matës – pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,05$ %

– gypi i lakuar referent (prover) apo gypi standard me piston (compact prover) – pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,03$ %

– mjeti krahasues matës (master metër) me enë me vëllim minimal që mundëson verifikimin e rrjedhës një minutëshe për rrjedhën maksimale të sistemit matës – pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,1$ %.

5.1.2. Termometri ndarjet e të cilit nuk duhet të jenë më të mëdha se $0,2$ °C.

5.1.3. Kronometri (Sekondmatës).

5.1.4. Etalonët nga pika 5.1.1. duhet të jenë të kalibruar.

5.2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

5.2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirë për punë në zyrë, për ruajtje të etalonëve dhe dokumentacionit:

5.2.2. Temperatura e ambientit gjatë kohës së verifikimit e mjeteve matëse rrjedhëse duhet të jetë në kufijtë prej 0 °C deri në 35 °C.

6. Sistemet matëse në autocisterna dhe sistemet e qëndrueshme matëse për GLN

6.1. ETALONËT DHE PAJISJET

6.1.1. Për verifikimin e mjeteve matëse mund të përdoren:

– ena matëse e etalonit me vëllimin më të vogël që mundëson verifikimin e rrjedhës një minutëshe për rrjedhën maksimale të sistemit matës – pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,05$ %

– gypi i lakuar referent (prover), me pasiguri maksimale $\pm 0,03$ %

– gypi i etalonit me piston (compact prover), me pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,03$ %

– mjeti krahasues matës (matës master) që mundëson verifikimin e rrjedhës një minutëshe për rrjedhën maksimale të sistemit matës – pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,2$ %.

- mjeti matës krahasues (master metër) me mundësi të rregullimit të rrjedhjeve sipas të cilave verifikohet mjeti matës i rrjedhjes, me pasiguri maksimale $\pm 0.2\%$

6.1.2. Termometri ndarjet e të cilit nuk duhet të jenë më të mëdha se $0,2\text{ }^{\circ}\text{C}$.

6.1.3. Kronometri (Sekondmatës).

6.1.4. Etalonët nga pika 6.1.1. duhet të jenë të kalibruar.

6.2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

6.2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirë për punë në zyrë, për ruajtje të etalonëve dhe dokumentacionit:

6.2.2. Temperatura e ambientit gjatë kohës së verifikimit të mjeteve matëse të rrjedhjes duhet të jetë në kufijtë prej $0\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri në $35\text{ }^{\circ}\text{C}$.

7. Mjetet matëse të vëllimit që nuk gjenden në sistem matës

7.1. ETALONËT DHE PAJISJET

7.1.1. Për verifikimin e mjeteve matëse mund të përdoret:

– ena matëse e etalonit me vëllimin më të vogël që mundëson verifikimin e rrjedhës një minutëshe për rrjedhën maksimale të sistemit matës – pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,05\%$

– mjeti krahasues matës (matës master) me enë me vëllim minimal që mundëson verifikimin e rrjedhës një minutëshe për rrjedhën maksimale të sistemit matës – pasiguria maksimale e matjes $\pm 0,1\%$.

7.1.2. Termometri ndarjet e të cilit nuk duhet të jenë më të mëdha se $0,1\text{ }^{\circ}\text{C}$.

7.1.3. Kronometri (Sekondmatës).

Etalonët nga pika 7.1.1. duhet të jenë të kalibruar

7.2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

7.2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirë për punë në zyrë, për ruajtjen e etalonëve dhe dokumentacionit:

7.2.2. Temperatura e ambientit të punës gjatë kohës së verifikimit të mjeteve matëse të rrjedhjes duhet të jetë në kufijtë prej $0\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri në $35\text{ }^{\circ}\text{C}$.

8. Kompensatorët e temperaturës

8.1. ETALONËT DHE PAJISJET

8.1.1. Pajisja me transmision, elektromotori dhe dy koka të njehsorëve me etalon për të treguar njëkohësisht sasi të kompensuara dhe të pa kompensuara.

8.1.2. Termometra me zhivë me diapazon matjeje prej $-38\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri $+10\text{ }^{\circ}\text{C}$ dhe prej $0\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri në $50\text{ }^{\circ}\text{C}$ me ndarje minimale prej $0,1\text{ }^{\circ}\text{C}$ për kontrollin e temperaturës së gjeneruar.

8.1.3. Banja me temperaturë me tregues të temperaturës së gjeneruar.

8.1.4. Termometër me ndarje prej $0,5\text{ }^{\circ}\text{C}$.

8.1.5. Etalonët nga pika 8.1.1.; 8.1.2 dhe 8.1.4 duhet të jenë të kalibruar.

8.2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

Trupi për vlerësim të konformitetit duhet ta ketë hapësirën për verifikimin e kompenzatorëve të temperaturës që duhet t'i plotësojë këto kushte:

8.2.1. Duhet të jetë e pastër dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme për verifikimin e papenguar të pajisjeve, të ketë hapësirë të mjaftueshme që të vendosen pajisjet e nevojshme, të mbrojtura nga ekspozimi direkt i rrezeve të diellit.

8.2.2. Në hapësirën përreth nuk duhet të ketë burime të dridhjeve që mund të ndikonin në saktësinë e matjeve.

8.2.3. Hapësira duhet të jetë e pajisur me raftë ose dollap për vendosjen e pajisjeve që verifikohet dhe për vendosjen e pajisjeve treguese që janë verifikuar.

8.2.4. Në hapësirë duhet të jetë edhe termometri kontrollues për matjen e temperaturës së ajrit të ambientit të punës me diapazon matës prej 15 °C deri në 25 °C, me ndarje minimale që tregon 0.1 °C.

8.2.5. Duhet të ketë ndriçimin natyral dhe elektrik.

8.2.6. Temperatura e ambientit të punës gjatë kohës së verifikimit të kompenzatorëve të temperaturës duhet të jetë në diapazonin prej 15 °C deri në 25 °C.

SHTOJCA 7

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE PËR VERIFIKIMIN E PAJISJEVE QË TREGOJNË VËLLIMIN PËRVEQ UJIT

Kërkesat e veçanta nga kjo Shtojcë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me rekomandimet në fuqi të Organizatës ndërkombëtare për metrologji ligjore (International Organization of Legal Metrology): OIML R 117.

1. ETALONËT DHE PAJISJET

1.1. Pajisja për verifikimin e funksionalitetit të kompjuterëve – njehsorëve elektronikë (përshkruar nga prodhuesi)

1.2. Osciloskopi.

1.3. Simulatori i pajisjes matëse (gjenerator i impulseve) – simulatori i rrjedhjes së lëngjeve.

1.4. Pajisje me transmission elektromotori dhe njehsor me kokë etaloni.

1.5. Termometër me ndarje 0,5 °C për matjen e temperaturës së ajrit në ambientet e punës.

1.6. Pajisjet duhet të jenë të verifikuara apo të kalibruara.

Grupi për verifikimin e kompjuterit të pajisjes treguese (njehsorëve elektronikë) përbëhet prej pajisjeve nga pikat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.5.

Grupi për verifikimin e njehsorit të pajisjes treguese (njehsorit me kokë mekanike) përbëhet prej pajisjeve nga pikat 1.4. dhe 1.5.

2. HAPËSIRAT DHE KUSHTET

2.1. Trupi i emëruar duhet ta ketë hapësirën e punës e cila duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

– të jenë të pastra, të thata dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme për verifikim të papenguar,

– të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve të nevojshme,

– të jenë të mbrojtura nga ekspozimi direkt i rrezeve të diellit,

– të kenë orendi për vendosjen e mjeteve matëse që testohen,

– të kenë ndriçim natyral dhe elektrik,

– në hapësirë dhe zonën përreth burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjeve,

– në hapësirë e punës duhet të jetë termometri për matjen e temperaturës së ajrit,

– të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës dhe, sipas nevojës, me kondicioner ajri.

2.2. Temperatura e ambientit në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 18 °C do 22 °C.

2.3. Termometrat duhet të jenë të vendosur në murin e hapësirës, në atë mënyrë që nga muri të jenë të larguar 10 cm deri në 15 cm, dhe lartësi prej 150 cm deri në 170 cm nga dyshemeja.

2.4. Burimet për ngrohjen e hapësirës duhet të jenë së paku 1,5 m larg nga pajisjet, d.m.th. nga vendi ku kryhen verifikimet dhe duhet të mundësojnë ngrohjen e njëtrajtshme të hapësirës.

SHTOJCA 8

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE TË RRJEDHJES SË VËLLIMIT TË GAZIT (GAZMATËSIT)

Kërkesat e veçanta nga kjo Shtojcë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me rekomandimin në fuqi të Organizatës ndërkombëtare për metrologji ligjore (International Organization of Legal Metrology): OIML R 137-1-2.

1. ETALONËT DHE PAJISJET

1.1. Etalonët për verifikimin e gazmatësve mund të jenë:

- pajisjet me kabanë (bell-prover) për verifikimin e gazmatësve
- pajisjet me gazmatës kontrolli (me etalon) për verifikimin e gazmatësve,
- grykë testuese e gazit me gryka kritike,
- pajisja për verifikimin e gazmatësve me kompensim të temperaturës.

1.2. Pajisja me kabanë (bell-prover) për verifikimin e gazmatësit përbëhet prej:

- pjesës matëse me pajisje ndihmëse,
- linja testuese me tavolinën për vendosjen e gazmatësit,
- mjet matës për matjen dhe rregullimin e rrjedhës së ajrit.

1.2.1. Pjesa matëse me pajisjet ndihmëse përbëhet nga:

- kambana në formë cilindri, baza e sipërme e së cilës është e mbyllur ndërsa baza e poshtme e hapur,
- shufra e shkallëzuar, e përforcuar në pjesën anësore të kabanës,
- ena me prerje tërthore në formë rrethi apo unaze rrethore e mbushur me ujë apo vaj mineral me dendësi të ulët dhe i hapur në pjesën e sipërme,
- binarët kënddrejtë që sigurojnë lëvizjen e duhur vertikale të kabanës,
- rrota e vendosur në pjesën e sipërme dhe të poshtme të kabanës që rrëshqet nëpër binarë kënddrejtë,
- kundërpesha që cakton shtypjen e ajrit nën kabanë,
- litari i çelikut apo zinxhiri i çelikut që lidhë kundërpeshën dhe kabanën,
- makaraja mbi të cilën është vendosur litari i çelikut apo zinxhiri i çelikut,
- gypi përmes së cilit ajri nga hapësira hyn nën kabanë apo nga kambana del në linjën testuese,
- valvula e cila kur vendoset në pozicionin “hapur” mundëson mbushjen e kabanës me ajër
- pika referuese e përforcuar në pjesën e sipërme të enës,
- termometri për matjen e temperaturës së ajrit nën kabanë,
- termometri për matjen e temperaturës së ujit apo vajit mineral në enë.

1.2.2. Linja testuese me tavolinën për vendosjen e gazmatësit përbëhet nga:

- valvulet hyrëse,

- tubacioni,
- tavolina për vendosjen e gazmatësit,
- manometri për matjen e presionit të ajrit në linjën testuese,
- manometrat për matjen e rënies së presionit në çdo gazmatës të testuar,
- termometri për matjen e temperaturës së ajrit në afërsi të linjës testuese,
- termometri për matjen e temperaturës së ajrit në linjën testuese,
- valvula dalëse.

1.2.3. Mjeti matës për matjen dhe rregullimin e rrjedhës së ajrit përbëhen nga:

- një apo më shumë rotametra me shkallë të shënjuara,
- një apo më shumë valvula për rregullimin e rrjedhës së ajrit,
- rotometri mbyllës,
- valvula për zgjedhjen e rrjedhës së ajrit që ka shkallë të shënjuara,
- valvula për rregullimin e rrjedhës së zgjedhur të ajrit.

1.2.4. Kambana, shkalla dhe ena duhet të jenë të punuar nga materiali apo legura e metaleve që e përballojnë korrozionin (çeliku i pakoroduar, zinku, bakri etj.).

1.2.5. Vëllimi i kabanës duhet të jetë: 50, 100, 150, 200, 300, 400, 500, 600, 800, 1000, 1500, 2000 apo 5000 dm³.

1.2.6. Rrjedha më e madhe e shprehur në m³/h që mund të arrihet me pajisjen me kabanë përcaktohet me barazimin: $Q_{max} = 25 V$ – për lexim vizual, apo $Q_{max} = 70 V$ – për lexim automatik – ku V është vëllimi i kabanës në m³.

1.2.7. Pajisja, kambana e së cilës ka vëllim prej 1000, 1500, 2000 apo 5000 dm³ lejohet krijimi i rrjedhës dy herë më të madhe se sa ajo që është përcaktuar në paragrafin 1.2.6.

1.2.8. Pajisje me kabanë duhet të jetë e konstruktuar në mënyrë që presioni i ajrit nën kabanë ,varësisht nga pozita e kabanës (thellësia e zhytjes së kabanës në lëngun me të cilin është e mbushur ena) të mos ndryshojë më shumë se ± 20 Pa (20 Pa = 0,2 mbar),

1.2.9. Kambana dhe linja e verifikimit duhet të jenë të padepërtueshme (te mos ketë rrjedhje anësore) edhe gjatë shtypjes më të madhe punuese të pajisjes me kabanë

1.2.10. Vlerat e ndarjeve dhe shenjave numerike në shufrën e kabanës, varësisht vëllimit të kabanës, janë dhënë në këtë tabelë:

Vëllimi i kabanës, në dm ³	Vlerat maksimale të ndarjeve, në dm ³	Shenja numerike, në dm ³
50	1	10
10, 150, 200, 300	5	50
400, 500, 600, 800, 1000, 1500	10	100
2000	20	200
5000	50	500

1.2.11. Vijat ndarëse duhet të jenë të vizatuara qartë dhe barabartë. Me vijën me gjatësi më të madhe duhet të shënohet:

- çdo vijë e pestë – nëse vlera e ndarjes është 1, 10 dhe 20 dm³
- çdo vijë e dytë – nëse vlera e ndarjes është 5 dhe 50 dm³.

1.2.12. Largësia mes vijave ndarëse nuk duhet të jetë më e vogël se 1,5 mm dhe duhet të jetë e barabartë.

1.2.13. Shufra shkallëzuar e kambanës e cila tregon vëllimin e ajrit nën kambanë ku gabimi i së cilës nuk guxon të jetë më i madhe se:

- $\pm 0,2\%$ e vëllimit sipas shkallës së kambanës, për secilin interval të kufizuar me vijën ndarëse zero ose vijën e fundit të shkallës së ziles dhe me çfarëdo numri të shënuar me vijë ndarëse të shkallës së kambanës.
- $\pm 0,4\%$ e vëllimit sipas shkallës së kambanës, për çdo interval të kufizuar me dy numra fqinje të shënuar me vija ndarëse të shkallës së këmbanës (përveç vijës ndarëse zero dhe vijës së fundit ndarëse të shkallës së këmbanës).

1.2.14. Tavolina për vendosje të gazmatësit duhet të përmbajë elemente për kyçjen e shpejtë të gazmatësit në linjën testuese.

1.3. Pajisja me gazmatës kontrollues (etaloni) për verifikimin e gazmatësit përbëhet nga:

- pjesa operative (punuese)
- linja testuese
- mjeti matës për matjen dhe rregullimin e rrjedhës së ajrit.

1.3.1. Linjën testuese e përbëjnë:

- valvula hyrëse
- gazmatësi kontrollues (etaloni)
- tubacioni
- manometri për matje e presionit tek gazmatësi i verifikuar dhe kontrollues (etaloni) në pikën referuese
- termometri për matjen e temperaturës së ajrit në linjën verifikuese para ose pas gazmatësit
- termometri për matjen e temperaturës së ajrit në linjën verifikuese para ose pas gazmatësit të testuar
- valvula dalëse.

1.3.2. Linja testuese mund të ketë:

- manometër për matjen e rënies së presionit nga gazmatësi i verifikuar dhe kontrollues (etaloni)
- manometër për matjen e rënies së presionit në gazmatësin e verifikuar
- manometër për matjen e rënies së presionit në gazmatësin kontrollues (etaloni).

1.3.3. Mjetet matëse për matjen dhe rregullimin e rrjedhës së ajrit përbëhen nga:

- dhënësi i impulsit, i cili më së shpeshti montohet në gazmatësin kontrollues (etaloni)
- pjesa rregulluese
- valvula.

1.3.4. Në linjën testuese të pajisjes me gazmatës kontrollues (etaloni) mund të vendoset më shumë se një gazmatës. Në këtë rast, për secilën gazmatës të verifikuese duhet të jetë manometri për

matjen e presionit të ajrit në linjën verifikuese para çdo gazmatësi ose në pikën referuese. Temperatura e ajrit në linjën verifikuese matet para gazmatësit të parë dhe pas gazmatësit të fundit.

1.3.5. Nëse testohen gazmatësit me madhësi G 250, dhe pajisje më e madhe, me gazmatës kontrollues (etaloni) mund të kontrollohen deri pesë gazmatës etaloni që vendosen veç e veç ose paralelisht në linjën testuese.

1.3.6. Pajisjet me gazmatës kontrollues (etaloni) tek të cilat ventilatori fryn ajrin përgjatë linjës verifikuese duhet ta ketë edhe enën për qetësimin e rrjedhës dhe për ta barazuar temperaturën e ajrit. Ena montohet menjëherë pas ventilatorit.

1.3.7. Linja testuese e pajisjes me gazmatës kontrollues (etaloni) duhet të jetë e padepërtueshme (të mos ketë rrjedhje anësore) gjatë mbi shtypjeve ose nën shtypjeve të pritura gjatë verifikimit të gazmatësit ose gjatë nën shtypjeve ose mbi shtypjeve prej 1 kPa (1 kPa = 10 mbar), nëse nën shtypjet ose mbi shtypjet më të mëdha të pritura janë më të vogla.

1.3.8. Si gazmatës kontrollues (etaloni) përdoret:

- gazmatësi me lëng, për verifikimin; e gazmatësit me lëng, gazmatësit me shakull (bellows gas metër) dhe gazmatësit me pistona rrotullues
- gazmatësi me pistona rrotullues, për verifikimin; e gazmatësit me pistona rrotullues, gazmatësit me shakull (bellows gas metër) dhe gazmatësit me turbinë
- gazmatësi me turbinë, për verifikimin; e gazmatësit me pistona rrotullues dhe gazmatësit me turbinë.

1.3.9. Që gazmatësi të përdoret si kontrollues (etaloni), duhet t'i plotësojë këto kushte:

- lakorja e gabimeve mesatare relative të gazmatësit (shprehur në përqindje) në funksion të rrjedhjes nga Q_{min} deri në Q_{max} duhet të gjendet brenda diapazonit në të cilin gabimi mesatar relativ është më i vogël se $\pm 1\%$
- gabimi relativ i gazmatësit (shprehur në përqindje) për matjet e veçanta gjatë rrjedhjes së njëjtë nuk guxon të devijojë më shumë se $\pm 0,1\%$ nga gabimi mesatar relativ i gazmatësit (shprehur në përqindje) për atë rrjedhje.

1.3.10. Lakorja e gabimeve mesatare relative të gazmatësit (shprehur në përqindje) në funksion e rrjedhjes nga Q_{min} deri në Q_{max} përcaktohet përmes gabimeve mesatare relative të gazmatësit (shprehur në përqindje) të fituara së paku nga 12 rrjedhje të ndryshme.

1.3.11. Gabimi mesatar relativ i gazmatësit (shprehur në përqindje) për vargun e matjeve gjatë rrjedhjes së caktuar fitohet me këtë formulë:

$$WME = \frac{\sum_{i=1}^n (k_i \times E_i)}{\sum_{i=1}^n k_i},$$

$$me: k_i = \frac{Q_i}{Q_{max}}, \text{ për } Q_i \leq 0.7 \times Q_{max}$$

$$k_i = 1.4 - \frac{Q_i}{Q_{max}}, \text{ për } 0.7 \times Q_{max} \leq Q_i$$

ku:

E_i – është gabimi relativ i gazmatësit (shprehur në përqindje) e fituar për rrjedhjen Q_i

k_i – koeficienti i rrjedhjes Q_i

n – numri i matjeve gjatë një rrjedhje të caktuar.

Numri më i vogël i matjeve për llogaritjen e gabimit mesatar relativ të gazmatësit (shprehur në përqindje) gjatë rrjedhës së caktuar është $n \geq 3$

1.4. Pajisja me grykë kritike për verifikimin e gazmatësit përbëhet nga:

- linja testuese
- blloqet me gryka kritike
- pjesa operative.

1.4.1. Si pjesë operative, përdoret një pompë vakumi, e cila duhet të ketë karakteristikë të tillë që të arrihet rrjedhje e mjaftueshme e ajrit dhe një vakum i tillë që të arrihet një rrjedhë kritike e ajrit në gryken kritike individuale, ku numri Mach është $Ma = 1$.

1.4.2. Linjën testuese e përbëjnë:

- valvula hyrëse
- tubacionet
- sensorët e presionit për matjen e rënies së presionit në secilin gazmatës të verifikuar
- sensorët e rënies së presionit për matjen e rënies së presionit përgjatë linjës matëse
- sensori i temperaturës në hyrje të linjës verifikuese
- sensori i temperaturës në dalje të linjës verifikuese
- sensori i presionit atmosferike
- sensori i lagështisë atmosferike
- valvulat dalëse.

1.4.3. Blloku me gryka kritike përbëhet nga:

- gryka kritike të lidhura paralelisht
- valvulet dalëse për gryka të caktuara
- sensori i presionit në hyrjen e grykës kritike
- sensori i temperaturës në hyrjen e grykës kritike.

Në linja verifikuese dhe blloqet me gryka kritike nuk duhet të ketë rrjedhje anësore.

1.4.4. Çdo grykë kritike duhet t'i plotësojë kërkesat që rrjedhjet e caktuara pas verifikimit të grykës nuk guxojnë të devijojnë më shumë se $\pm 0,5\%$ nga vlera mesatare e rrjedhjes për atë grykë.

1.4.5. Vlera mesatare e rrjedhjes së grykës caktohet nga një varg matjesh të një rrjedhje të caktuar sipas shprehjes:

$$Q = \frac{1}{n} \times \sum_{i=1}^n Q_i$$

ku:

Q , m^3/h - është vlera mesatare e rrjedhjes së grykës,

Q_i , m^3/h – vlerat e rrjedhjeve në gryke, në gjendjen $20\text{ }^\circ\text{C}$, 1000 mbar , $j=0\%$ e fituar nga matja e i -të

n – numri i matjeve të një rrjedhje të caktuar, i cili ka vlerën $n \geq 3$

1.5. Pajisja për verifikimin e gazmatësve me kompensimin e temperaturës përbëhet nga:

- pjesa operative
- linja testuese me gazmatësin kontrollues (etaloni)
- dhomëza për rregullimin e temperaturës së verifikimit të gazmatësit.

1.5.1. Si pjesë operative shfrytëzohet ventilatori ose vakum pompa.

1.5.2. Linja verifikuese përbëhet nga:

- valvula hyrëse (prapa tij mund të instalohet rregullatori i presionit të ajrit)
- tubacionet– sensorët e presionit tek gazmatësit e testuar dhe kontrollues (etaloni)
- shkëmbyesi i nxehtësisë (brenda dhe jashtë dhomëzës)
- termometri për matjen e temperaturës së ajrit në hyrje të gazmatësit të parë dhe në dalje të gazmatësit të fundit të testuar si dhe tek gazmatësi kontrollues (etaloni)
- matësi i rrjedhjes (gazmatësi kontrollues ose blloku me gryka kritike).

1.5.3. Nëse në linjën verifikuese së gazmatësit me korigjim të temperaturës është instaluar blloku me gryka kritike, duhet t'i plotësojë dispozitat e kësaj shtojce.

1.5.4. Dhomëza për rregullimin e temperaturës së verifikimit të gazmatësit duhet t'i plotësojë këto kushte:

- dhomëza duhet të jetë e punuar ashtu që dallimi mes temperaturës më të lartë dhe më të ulët gjatë matjes të mos jetë mbi ± 2 °C
- diapazoni i rregullimit të temperaturës duhet të jetë nga -20 °C deri +50 °C.

1.6. Gabimet maksimale të lejueshme që shfaqë mjetin matës për matjen dhe rregullimin e rrjedhjes së ajrit në pajisje janë $\pm 5\%$.

1.7. Për matjen e presionit në pajisjet me kambanë duhet të përdoren matësit e presionit dhe atë:

- manometrat me gyp në formën e shkronjës U ose manometra tjerë të presionit të përshtatshëm për kambanë
- manometrat e pjerrtë me gyp, ose manometra tjerë të presionit të përshtatshëm për kambanë.
- sensorët e presionit.

1.8. Manometrat e përdorur duhet ta kenë shkallën e saktësisë 1, gjegjësisht gabimet e matjes në përdorim nuk duhet të jenë më të mëdha se $\pm 1\%$ të presionit të matur.

1.9. Për matjen e temperaturës së pajisjeve duhet të përdoren termometrat laboratorikë nga qelqi, me vlerë të ndarjes që nuk është më e madhe se 0,1 °C.

1.10. Përveç tyre, mund të përdoren dhe lloje tjera të termometrave nëse në aspektin e saktësisë, përputhen me termometrat e përmendur në këtë paragraf.

1.11. Etalonët duhet të jenë të kalibruar.

2. HAPËSIRA DHE KËRKESAT

2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet ta ketë hapësirën e punës për verifikimin e gazmatësit, që duhet t'i plotësojë këtë kushte:

- të jetë e pastër, e thatë dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme për verifikim të papenguar
- të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve të nevojshme
- të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit
- në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjes
- të ketë hapësirë për vendosjen e mjeteve matëse të cilat verifikohen
- në hapësirë duhet të jenë tre termometra kontrollues për matjen e temperaturës së ajrit
- të ketë ndriçim natyral dhe elektrik

– të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës dhe sipas nevojës edhe me kondicioner ajri.

2.2. Temperatura e ambientit të punës gjatë verifikimit duhet të jetë brenda kufijtë prej 15 °C deri 25 °C dhe gjatë punës nuk duhet të luhetet më shumë se 2 °C.

2.3. Termometrat duhet të vendosen në tre mure të hapësirës, ashtu që të jenë 10 cm deri 15 cm larg nga muri, dhe lartësi 150 cm deri 170 cm mbi dysheme. Dallimet në temperaturën e ajrit në vendet e caktuara në hapësirën e punës nuk duhet të jenë më të mëdha se 1 °C.

2.4. Burimet e ngrohjes duhet të jenë së paku 1,5 m larg pajisjeve, gjegjësisht nga vendi ku kryhet verifikimi.

SHTOJCA 9

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE ME TË CILAT KORRIGJOHET VËLLIMI I GAZIT TË RRJEDHUR (KORREKTORËT)

Kërkesat e veçanta të kësaj Shtojce përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me rekomandimin në fuqi të Organizatës ndërkombëtare për metrologji ligjore (International Organization of Legal Metrology) OIML R 137-1-2.

1. ETALONËT DHE PAJISJET

1.1. Pajisja për verifikimin e korrektorit duhet ta ketë:

1.1.1. Aparatin për krijimin dhe matjen e shtypjes i cili është pajisje me pesha, presë me manometër ose kalibrues i presionit (manometër digjital):

– gabimi maksimal gjatë matjes së presionit nuk duhet të jetë më i madh se $\pm 0,2\%$ i shtypjes së matur

– nëse aparatet për krijimin dhe matjen e presionit janë të punuara si kundërvepruese, atëherë duhet të ekzistojë edhe pajisja për matjen e presionit atmosferik.

– gabimi maksimal në matjen e presionit atmosferike nuk duhet të jetë më i madh se ± 100 Pa.

1.1.2. Pajisja termostatike (termostat) për matjen e temperaturës:

– pajisja termostatike duhet të jetë i punuar asisoj që dallimi mes temperaturës më të lartë dhe më të ulët gjatë matjes mos jetë më e lartë se 0.2 K, përkatësisht 0.2 °C

– për ta matur temperaturën përdoren termometrat tek të cilët vlera e ndarjes nuk duhet të jetë më e madhe se 0.1 °C.

1.1.3. Aparati me të cilin simulohet rrjedhja e gazit:

– aparati me të cilin simulohet rrjedhja e gazit është motori, boshti dalës i të cilit mund t'i përshtatet lehtësisht llojeve të ndryshme të korrektorëve ose gjeneratorit me impulse elektrike

– aparati me të cilin simulohet rrjedhja e gazit duhet ta ketë mjetin matës për leximin e rrotullimeve të plota të boshtit të korrektorit, përkatësisht numrin e përgjithshëm të impulseve të dërguara.

1.2. Termometra (të paktën tre) me ndarje $0,1$ °C për matjen e temperaturës së ajrit të ambientit të punës.

2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirë të punës për verifikimin e korrektorit, që duhet t'i plotësojë këto kushte:

– të jetë e pastër, e thatë dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme për verifikimin papenguar të mjeteve matëse

– të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve të nevojshme

– të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit

– në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjes

- të ketë hapësirë për vendosjen e korrektorit që do të verifikohet
- të ketë hapësirë për vendosjen e korrektorit që janë verifikuar
- të ketë ndriçim natyral dhe elektrik
- në hapësirë duhet të jenë tre termometra kontrollues për matjen e temperaturës së ajrit
- të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës dhe sipas nevojës edhe me kondicioner ajri.

2.2. Temperatura e ajrit në hapësirën e punës për verifikimin e korrektorit duhet të matet me të paktën tre termometra, ndarja më e vogël e të cilëve nuk guxon të jetë më e madhe se $0.1\text{ }^{\circ}\text{C}$. Termometrat vendosen në tre mure të hapësirës, në largësi 10 cm deri 15 cm nga muri, dhe lartësi 150 cm deri 170 cm mbi dysheme. Dallimet në temperaturën e ajrit në vendet e caktuara në hapësirën e punës nuk duhet të jenë më të mëdha se $1\text{ }^{\circ}\text{C}$. Temperatura në hapësirën e punës nuk guxon që gjatë punës të ndryshoj më shumë se $2\text{ }^{\circ}\text{C}$. Temperatura e hapësirës së punës duhet të jetë në kufijtë prej $15\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri $25\text{ }^{\circ}\text{C}$.

2.3. Burimet e ngrohjes duhet të jenë së paku 1,5 m larg pajisjeve, gjegjësisht nga vendi ku kryhet verifikimi dhe duhet të mundësojë ngrohje të barabartë të hapësirës.

SHTOJCA 10

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIM E MJETEVE MATËSE LIGJORE TË MASËS

Kërkesat e veçanta të kësaj Shtojce përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me rekomandimet në fuqi me të Organizatës ndërkombëtare për metrologji ligjore (International Organization of Legal Metrology): OIML R 50-1, OIML R 106-1, OIML R 50-2, OIML R 106-2, OIML R 51-1, OIML R 107-1, OIML R 51-1, OIML R 107-2, OIML R 51-2, OIML R 111-1, OIML R 76-1, OIML R 111-2, OIML R 76-2 dhe OIML R 112.

Mjetet matëse për matjen e masës janë të shpërndara në fushat si në vijim:

1. Peshat e klasës F1, F2, M1, M2, M3 të saktësisë dhe peshë deri 20 kg
2. Peshat e klasës M1, M2, M3 të saktësisë dhe me peshë prej 50 kg deri 500 kg dhe 1000kg
3. Peshore jo-automatike e klasës (I) të saktësisë,
4. Peshore jo-automatike e klasës (II) të saktësisë
5. Peshore jo-automatike e klasës (III) dhe (III) të saktësisë, me matje maksimale deri 9000 kg
6. Peshore jo-automatike e klasës (III) dhe (III) të saktësisë, me matje maksimale mbi 9000 kg
7. Peshore automatike me matje maksimale deri 9000 kg
8. Peshore automatike me matje maksimale mbi 9000 kg.

1. Peshat e klasës F1, F2, M1, të saktësisë dhe peshë deri 20 kg

1.1. ETALONËT DHE PAJISJET

1.1.1. Kompleti metrologjik i peshave:

- me pesha me masë nominale prej 1 mg deri 20 kg,
- me pesha me të cilat kryhet verifikim duhet të jetë së paku i një klase më të lartë se pesha që verifikohet,
- të peshoret e cilat duhet ti përmbushin këto kushte:
 - a) stabiliteti i peshores gjatë matjes së përsëritur të së njëjtës peshë në kushte të pandryshuara, duhet të jetë në një të tretën e ndarjes më të vogël të peshores
 - b) vlera e ndarjes minimale të peshores nuk duhet të jetë më e madhe se një e treta e gabimit maksimal të lejuar e peshës e cila verifikohet.

Të gjitha peshat dhe peshoret qe përdoren për verifikimin e peshave tjera duhet të jenë kalibruara.

1.1.2. Pajisjet ndihmëse:

- termometri me ndarje së paku 0.1 °C për matjen e temperaturës në hapësirën e punës për verifikim,
- hygrometri për matjen e lagështisë relative në hapësirën e punës me ndarje 0.1%.
- manometri për matjen e presionit atmosferik të hapësirës punuese, me ndarje 0.1 mbar
- Peshat, Peshoret, Termometri, hygrometri dhe manometri duhet të jenë të kalibruar.

1.2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

1.2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet ta ketë hapësirën e punës, që duhet t'i plotësojë këto kushte:

- të jetë e pastër, e thatë dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme për verifikim të papenguar të peshave
- të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve dhe peshoreve
- të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit
- në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjes
- të ketë orendi - hapësirë për t'i vendosur peshat që verifikohen dhe që janë verifikuar
- në hapësirë duhet të jetë i vendosur termometri, higrometri, dhe manometri për ta matur temperaturën, lagështinë dhe presionin e ajrit të ambientit.
- të ketë ndriçim elektrik
- të ketë hapësirë e veçantë me hyrje që vjen nga paradhoma ose me dyer të dyfishta për verifikimin e peshave të klasës F1 dhe F2 të saktësisë.
- të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës dhe me kondicioner ajri.

1.2.2. Temperatura e ambientit të punës në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 18 °C deri 25 °C

1.2.3. Peshat duhet të verifikohen në kushte të qëndrueshme mjedisore.

Ndryshimi i lejuar i kushteve mjedisore:

Klasa e peshave	Ndryshimi i temperaturës gjatë verifikimit
F1	$\pm 1,5$ °C në orë, më së shumti ± 2 °C në 12 orë
F2	± 2 °C në orë, më së shumti $\pm 3,5$ °C në 12 orë
M1	± 3 °C në orë, më së shumti ± 5 °C në 12 orë
Klasa e peshave	Zona e lagështisë relative të ajrit
F	40% deri në 60% më së shumti $\pm 15\%$ në 4 orë

2. Peshat e klasave M1, M2, M3 të saktësisë dhe peshë nga 50 kg deri 500 kg dhe 1000 kg

2.1. ETALONËT DHE PAJISJET

2.1.1. Kompleti i peshave për kryerjen e shërbimeve metrologjik:

–të paktën të klasës F2 të saktësisë, për verifikimin e klasave M1, M2, M3 të saktësisë dhe masë nominale prej 20 kg deri 500 kg dhe 1000 kg

– peshoret të cilat përdoren duhet ti përmbushin këto kushte:

a) stabiliteti i peshores, matjet e përsëritura të së njëjtës masë në kushte të pandryshuara duhet të jenë në një të tretën e ndarjes më të vogël të peshores

b) vlera e ndarjes më të vogël të peshores nuk duhet të jetë më e madhe se një e treta e gabimit të lejuar maksimal të peshës e cila verifikohet.

Të gjitha peshat dhe peshoret që përdoren për verifikim gramarët tjerë duhet të jenë kalibruara.

2.1.2. Pajisjet ndihmëse:

- termometri me ndarje së paku 0.1 °C për matjen e temperaturës në hapësirën e punës për verifikimin peshave tjera
- hygrometri për matjen e lagështisë relative në hapësirën e punës me ndarje 0.1%.
- manometri për matjen e presionit atmosferik të hapësirës punuese, me ndarje 0.1 mbar
- Peshat, Peshoret, Termometri, hygrometri dhe manometri duhet të jenë të kalibruar

2.2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

2.2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet ta ketë hapësirën e punës, që duhet t'i plotësojë këto kushte:

- të jetë e pastër, e thatë dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme për verifikim të papenguar të peshave
- të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve dhe peshoreve
- të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit
- në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjes
- të ketë orendi - hapësirë për t'i vendosur peshat që testohen dhe që janë verifikuar
- në hapësirën e punës duhet të jetë termometri, hygrometri dhe manometri, për matjen e temperaturës, lagështisë dhe presionit në hapësirën punuese.
- të ketë ndriçim elektrik.
- të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës dhe, sipas nevojës edhe me kondicioner ajri.

2.2.2. Temperatura e ambientit të punës në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 18 °C deri 27 °C.

2.2.3. Peshat duhet të verifikohen në kushte të qëndrueshme mjedisore.

Ndryshimi i lejuar i kushteve mjedisore:

Klasa e peshës	Ndryshimet e temperaturës gjatë verifikimit
M1	$\pm 3^{\circ}\text{C}$ në orë, më së shumti $\pm 5^{\circ}\text{C}$ në 12 orë.

3. Peshoret jo-automatike të klasës (I) të saktësisë

3.1. ETALONËT DHE PAJISJET

3.1.1. Kompleti i peshave:

- të klasës E2 të saktësisë, për peshore me ndarje »e« e cila ka vlerën $0,001\text{ g} \leq e$, me masë nominale 1 mg deri 200 g, dhe masë të përgjithshme 500 g.

Peshat e caktuara dhe grupet e peshave duhet të jenë të kalibruara.

3.1.2. Pajisjet ndihmëse:

- Nivelizuesi (libela) e klasës së saktësisë të paktën II
- llupa me zmadhim për 10 here
- termometri për matjen e temperaturës në hapësirën e punës, me ndarje së paku 0.1 °C
- hygrometri për matjen e lagështisë relative në hapësirën e punës me ndarje 0.1%.
- manometri për matjen e presionit atmosferik të hapësirës punuese, me ndarje 0.1 mbar
- Peshat, Termometri, hygrometri dhe manometri duhet të jenë të kalibruar.

3.2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

3.2.1 Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirë të punës që duhet t'i plotësojë këto kushte:

- të jetë e pastër, e thatë dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme për verifikim të papenguar të peshoreve
- të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve dhe peshoreve
- të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit
- në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjes
- të ketë orendi – hapësirë për vendosjen matësve të masës për verifikim.
- në hapësirën e punës duhet të jetë termometri, hygrometri dhe manometri, për matjen e temperaturës, lagështisë dhe presionit të hapësirës punuese.
- të ketë ndriçim elektrik
- të jetë e ndërtuar si hapësirë e veçantë me hyrje nga paradhoma ose me dyer të dyfishta për verifikimin e peshoreve të klasës I të saktësisë
- të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës dhe sipas nevojës edhe me kondicioner ajri.

3.2.2. Temperatura e mjedisit të punës në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 20 °C deri në 25° C për peshoren e klasës I të saktësisë.

4. Peshoret jo-automatike të klasës (II) të saktësisë

4.1. ETALONËT DHE PAJISJET

4.1.1. Kompleti i peshave:

- të klasës F1 të saktësisë, për peshore, ndarësi shqyrtues »e« e cila ka vlerën 1 mg $e \leq 100$ mg, me masë nominale 1 mg deri së paku 5 kg, me masë të përgjithshme 20 kg
 - të klasës F2 të saktësisë, për peshore, ndarësi shqyrtues »e« e cila ka vlerën 0,1 g $e < 1$ g, me masë nominale 1 mg deri së paku 5 kg, me masë të përgjithshme 10 kg.
- Peshat e caktuara dhe grupet e peshave duhet të jenë kalibruara.
- Peshat e klasës më të ulët të saktësisë mund të zëvendësohen me sasinë e njëjtë të peshave të klasës më të lartë të saktësisë.

4.1.2. Pajisjet ndihmëse:

- Nivelizuesi (libela) e klasës së saktësisë të paktën II
 - llupa me zmadhim për 10 here
 - termometri për matjen e temperaturës në hapësirën e punës, me ndarje së paku 0.1 °C
 - hygrometri për matjen e lagështisë relative në hapësirën e punës me ndarje 0.1%.
 - manometri për matjen e presionit atmosferik të hapësirës punuese, me ndarje 0.1 mbar
- Peshat, Termometri, hygrometri dhe manometri duhet të jenë të kalibruar.

4.2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

4.2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirë të punës që duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të jetë e pastër, e thatë dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme për verifikim të papenguar të peshoreve
 - ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve dhe peshoreve
 - të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit
 - në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjes
 - të ketë orendi - hapësirë për vendosjen e matësve të masës që verifikohen dhe të atyre të verifikuar
 - në hapësirën e punës duhet të jetë termometri, hygrometri dhe manometri, për matjen e temperaturës, lagështisë dhe presionit të hapësirës punuese.
 - të ketë ndriçim elektrik.
 - të jetë e ndërtuar si hapësirë e veçantë me hyrje nga paradhoma ose me dyer të dyfishta për verifikimin e peshoreve të klasës II të saktësisë
 - të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës e sipas nevojës edhe me kondicioner ajri.
- 4.2.2. Temperatura e mjedisit të punës në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 20 °C deri 25 °C për peshoren e klasës II të saktësisë.

5. Peshoret jo automatike të klasave (III) dhe (III) të saktësisë me matje maksimale deri 9000 kg

5.1. ETALONËT DHE PAJISJET

5.1.1. Kompleti i peshave :

- të klasës M1 të saktësisë për peshore, ndarësi shqyrtues »e« e së cilës ka vlerën $\geq 1g$, me masë nominale 1 g deri 20 kg, me masë të përgjithshme 2000 kg
- të klasës M1 të saktësisë për peshore elektromekanike me masë nominale 100 mg x 10 copë deri 500 g x 10 copë.

Peshat e caktuara dhe grupet e peshave duhet të jenë të kalibruara.

Peshat e klasës më të ulët të saktësisë mund të zëvendësohen me sasinë e njëjtë të peshave të klasës më të lartë të saktësisë.

5.1.2. Pajisjet ndihmëse:

- Nivelizuesi (libela) e klasës së saktësisë të paktën II
- llupa me zmadhim për 10 herë
- termometri për matjen e temperaturës në hapësirën e punës, me ndarje së paku 0.1 °C
- hygrometri për matjen e lagështisë relative në hapësirën e punës me ndarje 0.1%.
- manometri për matjen e presionit atmosferik të hapësirës punuese, me ndarje 0.1 mbar
- Termometri, hygrometri dhe manometri duhet të jenë të kalibruar.

5.2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

5.2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirë të punës që duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të jetë e pastër, e thatë dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme për verifikim të papenguar të peshoreve
- të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve dhe peshoreve

- të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit
 - në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjes
 - të ketë orendi- hapësirë për vendosjen e matësve të masës që verifikohen dhe atyre të verifikuar
 - në hapësirë duhet të jetë termometri për matjen e temperaturës së ajrit
 - të ketë ndriçim elektrik dhe/ose natyral
 - të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës dhe, sipas nevojës edhe me kondicioner ajri.
- 1.2.2. Temperatura e mjedisit të punës në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 18 °C deri në 27° C për peshoret e klasave III dhe IIII të saktësisë.

6. Peshoret jo automatike me matje maksimale mbi 9000 kg

6.1. ETALONËT DHE PAJISJET

6.1.1. Kompleti i peshave- gramarëve:

- të klasës M1, të saktësisë, me masë nominale 20 kg deri 500 kg, masë të përgjithshme 20000 kg,
 - të klasës M1 të saktësisë, me masë nominale 200 g x 10 copë deri 5 kg x 10 copë
 - karroca e standardizuar për verifikimin e peshoreve hekurudhore (e peshuar në peshore me vlerë të ndarjes verifikues dhjetë herë më të vogël se vlera e ndarjes verifikuese të peshores hekurudhore).
- Peshat e caktuara dhe grupet e peshave duhet të jenë të kalibruara.

6.1.2. Pajisjet ndihmëse:

- Nivelizuesi (libela) e klasës së saktësisë të paktën II
 - llupa me zmadhim 10 x
 - termometri me ndarje 1 °C për matjen e temperaturës së ambientit.
- Termometri duhet të jetë i kalibruar.

6.2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

6.2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet ta ketë hapësirën e punës që duhet t'i plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- të jetë e pastër, e thatë dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve
- të ketë zyrë për punën e personave përgjegjës për verifikim.

6.2.2. Temperatura e mjedisit të punës gjatë verifikimit duhet të jetë në kufijtë prej 0 °C dhe 35 °C.

7. Peshoret automatike të matjes maksimale deri 9000 kg

7.1. ETALONËT DHE PAJISJET

7.1.1. Kompleti i peshave:

- të klasës E2 të saktësisë, për peshore, me ndarës shqyrtues »e« e të cilave ka vlerën $0,001 \text{ g} \leq e$, me masë nominale 1 mg deri 200 g, me masë të përgjithshme 500 g,
- të klasës F1 të saktësisë, për peshore, me ndarës shqyrtues »e« e të cilave ka vlerën $1 \text{ mg} < e \leq 100 \text{ mg}$, me masë nominale 1 mg deri minimum 5 kg, dhe masë të përgjithshme 20 kg,

- të klasës F2 të saktësisë, për peshore, me ndarës shqyrtues »e« e të cilave ka vlerën $0,1 \text{ g} < e < 1 \text{ g}$, me masë nominale 1 mg deri minimum 5 kg, dhe masë të përgjithshme 10 kg
 - të klasës M1 të saktësisë, për peshore, me ndarës shqyrtues »e« e të cilave ka vlerën $\geq 1 \text{ g}$, me masë nominale 1 g deri 20 kg, me masë të përgjithshme 2000 kg
 - të klasës M1 të saktësisë, për peshore elektromekanike me masë nominale 100 mg x 10 copë deri 500 g x 10 copë
 - zinxhirë të butë për verifikimin e peshoreve automatike me rripa.
- Peshat e caktuara dhe grupet e peshave duhet të jenë të kalibruara.

7.1.2. Pajisjet ndihmëse:

- Nivelizuesi (libela) e klasës së saktësisë të paktën II
- llupa me zmadhim 10 x
- termometri për matjen e temperaturës në hapësirën e punës, me ndarje së paku $0.1 \text{ }^\circ\text{C}$
- hygrometri për matjen e lagështisë relative në hapësirën e punës me ndarje 0.1%.
- manometri për matjen e presionit atmosferik të hapësirës punuese, me ndarje 0.1 mbar
- Termometri, hygrometri dhe manometri duhet të jenë të kalibruar.

7.2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

7.2.1 Trupi për vlerësim të konformitetit duhet ta ketë hapësirën e punës që duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve
- të ketë zyrë për punën e personave përgjegjës për verifikim.

7.2.2. Temperatura e mjedisit të punës gjatë verifikimit duhet të jetë mes $0 \text{ }^\circ\text{C}$ dhe $35 \text{ }^\circ\text{C}$.

8. Peshoret automatike me matje maksimale mbi 9000 kg

8.1. ETALONËT DHE PAJISJET

8.1.1. Kompleti i peshave:

- të klasës M1 të saktësisë, me masë nominale 20 kg deri 500 kg, me masë të përgjithshme 20000 kg
- të klasës M1 të saktësisë, me masë nominale 200 g x 10 copa deri në 5 kg x 10 copë
- karrocë standarde për verifikimin e peshoreve për matjen e automjeteve në lëvizje (të matura me peshore me vlerë të ndarjes verifikuese dhjetë herë më të vogël se vlera e ndarjes verifikuese për matjen e automjetit në lëvizje).

Peshat dhe grupet e peshave duhet të kenë vërtetimin e vlefshëm të kalibrimit.

8.1.2. Pajisjet ndihmëse:

- mbajtësit për vendosjen e pajisjeve matëse
- libela e klasës së saktësisë të paktën II
- llupa me zmadhim 10 herë
- termometri me ndarje $1 \text{ }^\circ\text{C}$ për matjen e temperaturën së hapësirës së punës.
- Termometri duhet të jetë i kalibruar.

8.2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

8.2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet ta ketë hapësirën e punës që duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të jetë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve
- të ketë zyrë për punën e personave përgjegjës.

8.2.2. Temperatura e mjedisit të punës gjatë verifikimit duhet të jetë në kufijtë 0 °C deri 35 °C.

SHTOJCA 11

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE TË LAGËSHTISË SË KOKRRAVE TË DRITHËRAVE DHE FARAVE PËR PRODHIMIN E VAJIT (MATËSIT E LAGËSHTISË)

Kërkesat e veçanta nga kjo Shtojcë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me rekomandimin në fuqi të Organizatës ndërkombëtare për metrologji ligjore (International Organization of Legal Metrology) OIML R 59.

1. SUBSTANCAT REFERUESE, PAJISJET

- 1.1. Mostrat e kokrrave të drithërave dhe farave për prodhimin e vajit (tani e tutje »mostrat«) – substanca referuese;
- 1.2. Termometri me ndarje prej 0,1 °C ose më të mirë për matjen e temperaturës së ajrit në ambientin e punës;
- 1.3. Hygrometri me ndarje 0.1 % ose më të mirë për matjen e lagështisë relative të ajrit në ambientin e punës;
- 1.4. Mostrat duhet të verifikohen, ndërsa pajisjet tjera matëse të verifikohen ose kalibrohen;

2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

- 2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirën e punës që duhet t'i plotësojë këto kushte;
 - 2.1.1. të jetë e pastër, e thatë dhe me hapësirë të mjaftueshme për verifikim të papenguar;
 - 2.1.2. të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve të nevojshme;
 - 2.1.3. të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit;
 - 2.1.4. të sigurohet që pluhuri, avulli i ujit dhe gazrat agresivë të mos depërtojnë në të;
 - 2.1.5. të ketë orendi për vendosjen e mjeteve matëse që verifikohen;
 - 2.1.6. të ketë ndriçim natyror dhe ndriçim elektrik;
 - 2.1.7. të ketë derën hyrëse të punuar në mënyrë që të mos ndikojë në kushte të ambientit;
 - 2.1.8. në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjeve;
 - 2.1.9. në hapësirë duhet të jetë termometri për matjen e temperaturës së ajrit;
 - 2.1.10. në hapësirë duhet të jetë hygrometri për matjen e lagështisë relative të ajrit;
 - 2.1.11. të jetë e pajisur me burimet e nxehtësisë/ftohjes për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës;
 - 2.1.12. të ketë ftohësin për ruajtjen e mostrave;
 - 2.1.13. Temperatura e ambientit të punës në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 20 °C deri 23 °C;
 - 2.1.14. Lagështia relative e ajrit në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 33% deri 55%;

2.1.15. Termometrat dhe hygrometrat duhet të vendosen në murin e hapësirës ashtu që të jenë 10 cm deri 15 cm larg murit, dhe lartësi prej 150 cm deri 170 cm mbi dysheme;

2.1.16. Burimet e ngrohjes/ftohjes së hapësirës duhet të jenë së paku 1,5 m larg pajisjeve, pra nga vendi ku bëhen verifikimet dhe duhet të mundësojnë ngrohjen të njëtrajtshme të hapësirës;

SHTOJCA 12

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE PËR VERIFIKIMIN E TERMOMETRAVE

Kërkesat e veçanta nga kjo Shtojcë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me rekomandimet në fuqi të Organizatës ndërkombëtarë për metrologji ligjore (International Organization of Legal Metrology): OIML R-7, OIML R-114 dhe OIML R-115.

1. Termometrat ndahen në zona si në vijim:

1.1. Termometrat nga qelqi të mbushur me lëng;

1.2. Termometrat Aneroid;

1.3. Termometrat dixhital;

1.4. Termometrat me Rezistor Pt.;

1.5. Termometrat Termoqift. TC;

1.6. Termometrat me Rreze Infra IR;

1.7. Termometrat medicinalë (humanë). Aneroid, dixhital, Me rreze Infra IR.

2. Termometrat nga qelqi të mbushur me lëng

2.1. ETALONËT DHE PAJISJET

2.1.1. Etaloni i temperaturës.

2.1.2. Etaloni i kalibruar i temperaturës duhet të jetë termometri, pasiguria matëse e të cilit është më e vogël ose e barabartë me vlerën e gabimit absolut më të madh të lejuar të termometrit të testuar.

2.2. Pajisjet për riprodhimin e temperaturave të dhëna, varësisht zonës matëse të termometrit të testuar, mund të jenë:

2.2.1. Pajisja për riprodhimin e temperaturës së shkrirjes së akullit që realizon temperaturën prej 0 °C me gabim maksimal të lejuar prej $\pm 0,01$ °C.

2.2.2 Banjat me termostat (me ujë, vajra, rërë, Alkohol, Air. Pike trefishe te ujit), që arrijnë temperaturën e caktuar në disa zona matëse dhe kanë:

- vëllim mjaft të madh dhe thellësi të mjaftueshme për zhytjen e termometrave etaloni dhe termometrave që testohen.

- mundësi për ruajtjen e temperaturës konstante në kufijtë prej $\pm 0,01$ °C

- devijim të temperaturës më të vogël ose të barabartë me $\pm 0,05$ °C në tërë hapësirën e punës dhe në të gjitha kushtet e punës (kur termometrat janë të zhytur në banjë).

2.3. Kronometri i kalibruar ose i verifikuar me saktësi 0,1 s/h.

2.4. Pajisjet e kalibruara ose të verifikuara për përcjelljen e kushteve të ambientit të punës (temperaturat prej 0 °C deri +50°C me saktësi $\pm 0,2$ °C ose më të mirë, matës i presionit, per matjen e presionit atmosferike prej 950 hPa deri 1050 hPa me saktësi $\pm 0,5$ hPa ose me të mirë dhe matës

i lagështisë relative prej 20% deri 95% për matjen e lagështisë relative me saktësi $\pm 4\%$ ose më të mirë) me mundësi të regjistrimit të të dhënave.

2.5. Etalonët duhet të janë të kalibruar.

3. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

3.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirën ku mund të kryhet vetëm verifikimi dhe hapësirën ku kryhet riparimi i mjeteve matëse.

3.2. Hapësira për verifikimin e termometrave duhet:

3.2.1. të jetë e pastër, e thatë dhe me hapësirë të mjaftueshme për verifikim të papenguar të matësve

3.2.2. të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve të nevojshme

3.2.3. të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit

3.2.4. të ketë orendi për vendosjen e pajisjeve matëse

3.2.5. të ketë orendi për vendosjen e mjeteve matëse që testohen

3.2.6. të ketë ndriçim natyror, si dhe ndriçim elektrik

3.2.7. në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjeve

3.2.8. në hapësirën e punës duhet të vendoset pajisja për përcjelljen e kushteve të ambientit të punës në zonat matëse dhe saktësisë së përcaktuar në pikën 2.4 të kësaj Shtojce

3.2.9. të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të një trajtshme të hapësirës së punës dhe sipas nevojës me kondicioner ajri.

3.2.10. Temperatura e ambientit të punës në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej $18\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri $25\text{ }^{\circ}\text{C}$, ndërsa ndryshimi i temperaturës së ambientit të punës gjatë kohës së verifikimit të termometrave nuk duhet të jetë më i madh se $1\text{ }^{\circ}\text{C}$.

3.2.11. Burimet e ngrohjes së hapësirës duhet të janë të paktën 1,5 m larg nga pajisjet, respektivisht nga vendi ku kryhet verifikimi duhet të mundësojnë ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës.

4. Termometrat medicinalë (humanë)

4.1. ETALONËT DHE PAJISJET

4.1.1. Termometri standard i kalibruar nga qelqi ose termometri digjital me sondë rezistuese nga platini me saktësi $\pm 0,02\text{ }^{\circ}\text{C}$ ose më të madhe, në diapazon prej $+30\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri $+45\text{ }^{\circ}\text{C}$.

4.1.2. Banja e ujit e verifikuar me termostat me diapazon pune prej $+30\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri $+45\text{ }^{\circ}\text{C}$ me gradient horizontal dhe vertikal maksimal $\pm 0,03\text{ }^{\circ}\text{C}$ dhe me qëndrueshmëri më të mirë ose të barabartë me $\pm 0,03\text{ }^{\circ}\text{C}$ në kohëzgjatje prej 10 minutash.

4.1.3. Centrifuga për termometrat humanë të mbushur me lëng që arrin nxitimin centrifugal prej 600 m/s^2 .

4.1.4. Kronometri duhet të jetë i kalibruar apo i verifikuar.

4.1.5. Vend i përshtatshëm për vendosjen e termometrave humanë që verifikohen në banjën me termostat.

4.1.6. Pajisjet të kalibruara ose të verifikuara për përcjelljen e kushteve të ambientit të punës duhet të jenë sipas saktësisë në pikën 2.4 të kësaj shtojce.

HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

5. Hapësirat dhe Kërkesat që duhet ti posedoj trupi për vlerësim të konformitetit

5.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirën ku mund të kryhet vetëm verifikimi dhe duhet të jetë e ndarë nga hapësirat tjera.

5.2. Hapësira për verifikimin e termometrave duhet:

5.2.1. të jetë e pastër, e thatë dhe me hapësirë të mjaftueshme për verifikim të papenguar të mjeteve matëse

5.2.2. të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve të nevojshme

5.2.3. të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit

5.2.4. të ketë orendi për vendosjen e pajisjeve matëse

5.2.5. të ketë orendi për vendosjen e matësve që verifikohen

5.2.6. të ketë ndriçim natyral dhe elektrik

5.2.7. në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjeve

5.2.8. në hapësirën e punës për verifikim duhet të vendoset pajisja për përcjelljen e kushteve të ambientit sipas saktësisë së përcaktuara në pikën 2.4. të kësaj Shtojce

5.2.9. të ketë derën hyrëse të punuar ashtu që ajo mos të ndikoj në kërkesat e ambientit në hapësirës verifikuese.

5.2.10. të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës dhe sipas nevojës me kondicioner ajri.

5.2.11. Temperatura e ambientit të punës në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 18 °C deri 25 °C, ndërsa ndryshimi i temperaturës së ambientit të punës gjatë kohës së verifikimit të termometrave nuk duhet të jetë më i madh se 1 °C.

5.2.12. Burimet e ngrohjes së hapësirës duhet të jenë të paktën 1,5 m larg nga pajisjet, respektivisht nga vendi ku kryhet verifikimi dhe duhet të mundësojnë ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës dhe sipas nevojës të ketë edhe kondicioner.

SHTOJCA 13

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN MJETEVE MATËSE LIGJORE E MANOMETRAVE, VAKUUMMETRAVE, MANOVAKUUMOMETRAVE, KONVERTUESËVE (SHNDËRRUESVE) MATËS TË SHTYPJES, APARATEVE PËR MATJEN E SHTYPJES SË GJAKUT, APARATEVE PËR MATJEN E SHTYPJES

Kërkesat e veçanta nga kjo Shtojcë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me rekomandimin në fuqi të Organizatës ndërkombëtare për metrologji ligjore (International Organization of Legal Metrology): OIML R-23. OIML R-148 dhe OIML R-149

1. ETALONËT DHE PAJISJET

1.1. Pajisjet e nevojshme- etalonët për verifikimin e mjeteve matëse të presionit janë:

– Etalon i presionit me saktësi 0.025% ose me i mire, pompa presioni ose vakum pompa me aksesoret dhe konvertuesit e nevojshëm për matjen e presionit ose cilido etalon tjetër gjegjës për presion me saktësi 0.025% ose me i mire, varësisht llojit të matësit të presionit për të cilin kërkohet autorizim.

– paisjet e duhura dhe veglat për kontrollimin, riparimin dhe verifikimin e matësve të presionit, siç janë: vazhduesit e ndryshëm, elementet lidhëse, adaptuesit, çelësat dhe të ngjashme.

1.2. Për verifikimin e saktësisë së aparatit për matjen e shtypjes së gjakut nevojitet:

- Etaloni me saktësi : +/- 0.5 mmHg ose me i mire

- kronometri

– pompa e dorës me valvul lëshues dhe aksesor te nevojshëm

– ena e fortë metalike me vëllim 500 ml, respektivisht 100 ml

– enët për pranimin dhe mbajtjen e zhivës së rrjedhur.

1.3. Për verifikimin e saktësisë së mjetit matës të shtypjes absolute nevojitet:

– Etaloni me saktësi 0.01 % FS ose më i mirë.

- Enë vakumi

- Pompë vakumi me aksesoret e nevojshëm

1.4. Për verifikimin e konvertueseve matës të presionit pa pajisjen treguese nevojitet:

– Etalon për verifikimin e mjetit matës elektrik (tensionit) të presionit me saktësi 0.025% FS ose më i mire.

1.5. Termometri me ndarje prej 0,1 °C për matjen e temperaturës së ajrit të ambientit të punës.

1.6. Hygrometri me ndarje prej 0.1 % për matjen e lagështisë relative të ajrit të ambientit të punës.

1.7 Barometer me ndarje 0.1 mbar, për matjen e presionit ajrit në ambientin e punës.

Etalonët me të cilët verifikohen mjetet matëse të presionit duhet të janë të kalibruar.

2. HAPËSIRAT DHE KUSHTET

2.1. Trupi i emëruar duhet ta ketë hapësirën e punës për verifikimin e matësve të presionit e cila duhet t'i plotësojë këto kushte:

- të jetë e pastër, e thatë dhe me hapësirë të mjaftueshme për verifikim të papenguar dhe verifikim të matësve të presionit.
- të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve të nevojshme
- të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit
- në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjeve
- të ketë orendi për vendosjen e matësve të cilët verifikohen
- në hapësirë duhet të jetë termometri për matjen e temperaturës së ajrit
- në hapësirë duhet të jetë hygrometri për matjen e lagështisë relative të ajrit
- të ketë ndriçimin natyral dhe elektrik
- të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës dhe sipas nevojës edhe me kondicioner ajri.

2.2. Temperatura e ambientit të punës në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 18 °C deri 28 °C.

2.3. Burimet e ngrohjes së hapësirës për verifikimin e matësit të shtypjes duhet të janë të paktën 1,5 m larg nga pajisjet, respektivisht nga vendi ku kryhet verifikimi i matësve të shtypjes dhe duhet të mundësojnë ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës për verifikimin e mjetit matës të shtypjes.

SHTOJCA 14

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE PËR VERIFIKIMIN E NJEHSORËVE TË ENERGIJISË ELEKTRIKE

Kërkesat e veçanta nga kjo Shtojcë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me rekomandimet në fuqi të Organizatës ndërkombëtare për metrologji ligjore (International Organization of Legal Metrology): OIML R 46-1/-2 dhe OIML R 46-3.

1. ETALONËT DHE PAJISJET

1.1. Pajisja për verifikimin e njehsorëve (etaloni me vatmetra dhe/ose njehsorë etaloni).

Vatmetrat etalon të instaluar në pajisje duhet të janë:

– të paktën të klasës 0.2 të saktësisë dhe rrymës nominale 5 A ose 1 A – nëse janë instaluar në pajisjen për verifikimin e njehsorëve të

klasës 2 dhe 3 të saktësisë (A)

– të paktën të klasës 0.1 të saktësisë– nëse janë të instaluar në pajisjen për verifikimin e njehsorit të klasës 0.2 S, 0.5 S, 0.5 dhe 1 të

saktësisë (A,B,C)

Njehsorët etalon të instaluar në pajisje duhet të janë:

– Njehsorët etalon të paktën duhet të janë të klasës 0.2 të saktësisë– nëse janë instaluar në pajisjen për verifikimin e njehsorit të klasës 2 dhe 3 të saktësisë (A)

– Njehsorët etalon të paktën duhet të janë të klasës 0,05 të saktësisë– nëse janë të instaluar në pajisjen për verifikimin e njehsorëve të

klasës 0.2 S, 0.5 S, 0.5 dhe 1 të saktësisë (A,B,C).

1.2. Mjeti matës i kohës.

1.3. Mjetet matëse kontrolluese (ampermetrat, voltmetrat, frekuencometrat e ngjashëm).

Për kontrollin e herëpashershëm të ampermetrave, voltmetrave dhe frekuencometrave të instaluar në pajisjet e kontrollit, duhet të ekzistojë mjeti matës kontrollues për verifikimin e klasës së tyre të saktësisë të paktën 0.2 (nëse verifikimi kryhet me metodën fuqia –koha).

1.4. Pajisja për verifikimin e izolimit të njehsorëve.

Pajisja për verifikimin e izolimit të njehsorit duhet të ketë fuqinë të paktën 500 VA, dhe diapazon tensioni 2000 V, ose 4000 V kur tensioni ka formën sinusoidale. Vendosija e tensionit duhet të jetë e pandërprerë prej 0 V deri 2000 V respektivisht 4000 V, me ç ‘rast tensioni matet me voltmetër të paktën të klasës 1,5 të saktësisë.

1.5. Burimet e furnizimit.

Burimet e furnizimit të pajisjes për verifikimin e njehsorëve duhet, gjatë ndryshimit të tensionit të furnizimit prej $\pm 10\%$ dhe frekuencës prej $\pm 1\%$ nga vlerat nominale, në kyçjet dalëse të pajisjes për verifikimin e njehsorit, t'i sigurojnë kushtet referente (në aspektin e shumës së tensionit,

rrymës dhe frekuencës, formës së valëve të tensionit dhe rrymës, renditjes së fazave dhe baraspeshës së tensionit dhe rrymës) në përputhje me kërkesat matëse për klasën e saktësisë dhe llojin e njehsorëve të cilët testohen. Koha për rregullimin e tensionit nuk guxon të jetë më e gjatë se 0,5 s.

Me rastin e ndryshimit të ngarkesës së burimit të furnizimit nga puna boshe e boshtit deri 75% të ngarkesës nominale, ndryshimi i tensionit të qëndrueshëm nuk guxon të jetë më i madh se $\pm 0,1\%$, respektivisht $\pm 0,05\%$ nga diapazoni nominal i matjes, gjatë së cilës koha e rregullimit të tensionit nuk guxon të jetë më e gjatë se 1 s.

1.6. Mbajtëset për vendosjen e pajisjeve matëse.

Mbajtëset për vendosjen e njehsorëve duhet ta mundësojnë qëndrimin e njehsorëve në pozitën vertikale.

Gjatë diapazonit më të ulët të tensionit të matur të pajisjes për verifikimin e njehsorëve dhe gjatë numrit më të madh të njehsorëve që mund të vendosen në mbajtëse, rënia e tensionit në qarqet e tensionit të mbajtësit mbi të cilin vendosen njehsorët nuk duhet të jetë më e madhe se:

- 0,1% e vlerës nominale të tensionit të njehsorit – kur në mbajtës janë vendosur njehsorët e energjisë aktive elektrike të klasës 2 të saktësisë dhe njehsorët e energjisë elektrike reaktive të klasës 2 dhe 3 (A) të saktësisë
- 0,015% të vlerës nominale të tensionit të njehsorit – kur në mbajtës janë vendosur njehsorët e energjisë elektrike aktive të klasës 0,2 S; 0,5 S; 05 dhe 1.,(B,C) të saktësisë.

1.7. Termometri me ndarje të paktën 0,1 °C për matjen e temperaturës në hapësirën e punës.

1.8. Hygrometri me ndarje të paktën 0.1 % për matjen e lagështisë relative të ajrit në hapësirën e punës.

Etalonët dhe pajisjet në pikat 1.1.;1.2.;1.3;1.4;1.7. dhe 1.8 dhe duhet të janë të kalibruara

Ose Sistemin matës digjital automatik me parametrat e mëposhtme:

2. Sistemi matës testues digjital automatik mundëson kalibrimin dhe verifikimin e njëkohshëm të njehsorëve të energjisë elektrike me shumë pozita (**5; 10; 20;...**). Me këtë Sistem matës testues mund të testohen njehsorët induktiv, elektronik, elektronik multifunksional, grupet matëse transformatorike, multi-kuadrante me regjistra të energjisë/fuqisë aktive/reaktive të klasave të saktësisë:(3; 2; 1; 1%; 05; 0.5%; 0.5S; 0.2; 02S).

2.1. Sistemi i pajisjes testuese duhet të përbëhet nga :

- 3 burime integruese të tensionit VIS – 400; VIS – 1200; VIS – 2600; Brezi i tensionit 30....350V;
- 3 burime integruese të rrymës CIS – 600 ;CIS – 1600; CIS – 3000; CIS – 3600; brezi i rrymës 1mA120A....160A;
- njësinë kontrolluese të rrymës dhe tensionit Controll Unit ACU – 3000;.....
- etalonin e punës, etaloni referent me klasë të saktësisë 0.02%, lloji i rrymës deri 120 A; 160A,

- softveri automatik ekzekutiv i bazuar në Windows® versioni i viteve të fundit.

2.2. Softveri kontrollues duhet të ketë:

- Plotësisht përputhje me IEC, MID, INMETRO, ANSI, JJG dhe standarde të tjera
- Fleksibilitet të jashtëzakonshëm dhe funksionim të lehtë
- Integrim me sistemet e prodhimit dhe gjurmueshmërisë
- Mënyrat automatike dhe manuale të testimit
- Krijimin automatik të raporteve të verifikimit, eksportimi në TXT, Excel ose lloje të tjera të dhënash individuale
- Të gjitha llojet e njehsorëve dhe përkufizimet e provës të përfshihen në bibliotekat e softuerit
- Versione në shumë gjuhë
- Pajtueshmëria me protokollet: IEC 62056-21 (IEC 1107 i vjetër), DLMS, EDL, MODBUS, DL/T 645 dhe të tjerët sipas kërkesës
- Mënyra me NJË BUTON për vëllimet e prodhimit

2.3. Banaku – tavolina testuese duhet të ketë:

- Raftin për vendosjen e njehsorëve të energjisë elektrike me shumë pozita (**5; 10; 20; 40; ...**)
- çdo pozitë duhet të ketë llogaritësin e gabimeve
- çdo pozitë duhet të ketë fotokokat për skanim, lexim të rezultateve të matjes
- çdo pozitë duhet të ketë sondën e portit optike për lexim OPTO – porti
- çdo pozitë duhet të ketë transformatorin rrymor CTS – 120; CTS – 160; CTS – 200;
- sistemi matës duhet të jetë me lidhje të mbyllura I-P link (pozitat janë të pa varura njëra prej tjetrës)
- duhet të jetë multi tarifor, deri 16 tarifa
- duhet të ketë hend hellin – terminalin e dorës HHT për lexim të të dhënave të njehsorëve

2.4. Specifikimet kryesore teknike dhe metrologjike:

- Etaloni referent trefazor/ etaloni i punës duhet të jetë i integruar në banakun për testimin e njehsorëve
- Etaloni referent duhet të ketë një saktësi tipike prej $\pm 0,01\%$ @ PF=1 për të gjitha funksionet e matjes në të gjithë brezin e tij të funksionimit, me një saktësi maksimale të rastit më të keq prej $\pm 0,02\%$ @ PF ≥ 0.5 . Ky specifikim i saktësisë në rastin më të keq përfshin variablat e stabilitetit, faktorit të fuqisë, pasigurisë së gjurmueshmërisë dhe gabimeve të sistemit të testimit.
- Duhet të ketë dizajn unik që bën të patejkalueshëm në aftësinë e tij për të matur me saktësi format valore të "botës reale".

- Etaloni referent duhet të përfshin një konvertues eksklusiv të sinjalit analog në dixhital që është i kombinuar me transformatorët e njohur të hyrjes së tensionit dhe rrymës të kompensuar elektronikisht me hulumtim dhe një referencë të mbyllur hermetikisht. Ky kombinim siguron shkallën më të lartë të saktësisë, stabilitetit dhe shkathhtësisë të ofruar në një etalon portabël trefazor.
- Opsioni i Analizës Harmonike bën të mundur analizimin e ngarkesave sipas rendit të 64-të harmonik. Një opsion i integruar i Krahasuesit ofron llogaritjet automatike të rezultateve të testimit për njehsorët që testohen.
- Brezi matës $3 \times 1 \text{ mA} \dots 120 (200)\text{A}$ (1) diapazon automatik
- Brezi i tensionit $3 \times 30 \dots 630\text{V}$; $3 \times 30 \dots 525\text{V}$ @60Hz; me rangun automatik
- Brezi automatikë $3 \times 30 \dots 525 \text{ V}$ @50 Hz
- Brezi i fuqisë ndihmëse $3 \times 60 \dots 630\text{V}$ me rreze automatike
- Frekuenca e $40 \dots 70 \text{ Hz}$ themelore (2)
- Brezi i faktorit të fuqisë
- Brezi i temperaturës së funksionimit $-20^\circ\text{C} \dots +70^\circ\text{C}$
- Lagështia relative $0 \dots 95\%$, jo kondensuese

2.5. Mënyrat e matjes

- 2 tela aktiv dhe reaktiv
- 3 tela aktiv
- Modaliteti reaktiv me 3 tela i vërtetë ose i ndërlidhur
- 3 tela janë të dukshme
- Modaliteti aktiv me 4 tela
- Modaliteti reaktiv me 4 tela i vërtetë ose i ndërlidhur
- 4 tela të dukshme
- Funkcionet matëse katër kuadrante, trefazore, matje e njëkohshme e energjisë (aktive, reaktive, e dukshme), fuqisë (aktive, reaktive, e dukshme), tensioneve, rrymave, faktorëve të fuqisë, këndeve fazore, harmonike
- Saktësia e fuqisë/energjisë saktësia tipike: $\pm 0.01\%$ @ PF=1
- Saktësia e rastit më të keq: $\pm 0,02\%$ @ PF $\geq 0,5$
- Saktësia aktuale $\pm 0,014\%$ (140 ppm)
- Saktësia e tensionit $\pm 0,01\%$ (100 ppm)
- Zhvendosja afatgjate e fuqisë/energjisë viti 1: $\pm 0.0028\%$ / pesë vitet e 1: $\pm 0.0062\%$ / dhjetë vitet e 1: $\pm 0.0088\%$
- Zhvendosja afatgjate e rrymës $\pm 0,0021\%$ vitin e parë
- Zhvendosja afatgjate e tensionit $\pm 0,0014\%$ vitin e parë
- Saktësia e këndit $\pm 0,006^\circ$
- Zhvendosja e temperaturës $+20^\circ\text{C} \dots +30^\circ\text{C}$ asnjë $-20^\circ\text{C} \dots +70^\circ\text{C}$ $\pm 0,0005\%/^\circ\text{C}$ ($\pm 5 \text{ ppm}/^\circ\text{C}$)

- Hyrja e portës së ekranit BNC me tërheqje 150Ω deri në 5V, e mbërthyer në shpejtësinë e portës 5.7V
- Gjërsia minimale e impulsit 200 ns, shpejtësia maksimale e përsëritjes 20 Hz
- Lloji i daljes- kolektor i hapur, i mbërthyer në 27V
- Vlera e paracaktuar e daljes së impulsit BNC 0.00001 Wh/puls por mund të riprogramohet
- Frekuenca e daljes maksimale 2,1 MHz (minimumi i gjerësisë së pulsit 200 ns)
- Ekрани opsional
- Karakteristika të tjera të mundshme (opsionale) Krahasues i integruar, Analiza harmonike
- Brezi i funksionimit. Brezi i specifikuar nga 10 mA deri në rrymën maksimale.
- Brezi i funksionimit. Brezi i specifikuar nga 45 në 65 Hz.

Etalonët dhe pajisjet në pikat 2.4 duhet të janë të kalibruara

3. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

3.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet ta ketë hapësirën e punës që duhet t'i plotësojë këto kushte:

- të jetë e pastër, e thatë dhe me hapësirë të mjaftueshme për verifikimin e papenguar
- të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve të nevojshme
- të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit
- të ketë rafte, karroca respektivisht panele për vendosjen e njehsorëve që testohen
- të ketë dysheme horizontale-antistatike.
- të ketë ndriçim natyral dhe elektrik
- në hapësirë dhe për rreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjeve
- në hapësirë duhet të jetë termometri për matjen e temperaturës së ajrit
- në hapësirë duhet të jetë hygrometri për matjen e lagështisë relative të ajrit
- ta ketë derën hyrëse të punuar ashtu që ajo mos të ndikojë në ndryshimin e kushteve të ambientit në hapësirën verifikuese.
- të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës dhe sipas nevojës edhe me kondicioner ajri.

3.2. Temperatura e ambientit të punës në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 21 °C deri 25 °C.

3.3. Lagështia relative e ajrit në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 25 deri 75%.

3.4. Termometrat dhe higrometrat duhet të vendosen në murin e hapësirës ashtu që të janë larg nga muri të paktën 10 cm deri 15 cm, dhe lartësi prej 150 cm deri 170 cm mbi dysheme.

3.5. Burimet e ngrohjes së hapësirës duhet të janë të paktën 1,5 m larg nga pajisjet, respektivisht nga vendi ku kryhet verifikimi dhe duhet të mundësojnë ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës.

3.6. Verifikimi duhet të kryhet me pajisjen më precize, varësisht nga klasa e saktësisë e mjetit matës

SHTOJCA 15

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE TË TRANSFORMATORËVE MATËS

Kushtet e veçanta nga kjo Shtojcë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me standardet në fuqi të Komisionit ndërkombëtar elektroteknik (International Electrotechnical Commission): IEC 60044-1 dhe IEC 60044-2.

1. ETALONËT DHE PAJISJET

1.1. Pajisja për matjen e gabimeve.

Si pajisje për matjen e gabimeve mund të përdoren urat matëse (analoge ose digjitale).

1.2. Transformatorët etalon, rezistuesi etalon dhe ndarësit e tensionit.

1.2.1. Për verifikimin e transformatorëve matës të rrymës mund të përdoren:

- transformatorët etalon të rrymës.
- komparatorët e rrymës.

1.2.2. Për verifikimin e transformatorëve matës të tensionit mund të përdoren:

- transformatorët etalon të tensionit
- ndarësi i tensionit etalon kapacitiv për tensionet mbi 300 kV.

1.3. Ngarkesa

1.3.1. Ngarkesa reale e transformatorit matës përbëhet nga:

- ngarkesa standarde e rrymës
- pajisja për matjen e gabimeve
- ampermetri, nëse është i kyçur
- përcjellësit (konduktorët) hyrës dhe dalës mes mbështjellësit sekondar të transformatorit etalon të rrymës dhe pajisjes për matjen e gabimeve.

1.3.2. Ngarkesa reale e transformatorit matës të tensionit përbëhet nga:

- ngarkesa standarde e tensionit
- pajisjes për matjen e gabimeve
- voltmetrit, nëse është i kyçur.

1.4. Mjeti matës për matjen e rrymës, tensionit dhe frekuencës.

1.5. Pajisja për prodhimin e rrymave, respektivisht tensioneve.

1.6. Pajisja për vënien e rrymave, respektivisht tensioneve.

1.7. Termometri me ndarje 0.1 °C për matjen e temperaturës së ajrit në hapësirën e punës.

1.8. Higrometri me ndarje 0.1% për matjen e lagështisë relative të ajrit në hapësirën e punës.

Etalonët nën pikat 1.1, 1.2. dhe 1.3, duhet të janë te kalibruara, ndërsa pajisjet tjera matëse duhet të janë të verifikuara ose të kalibruara.

2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet ta ketë hapësirën e punës që duhet t'i plotësojë këto kushte:

- të jetë e pastër, e thatë dhe me hapësirë të mjaftueshme për verifikim të papenguar
- të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve të nevojshme
- të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit
- të ketë ndriçim natyral dhe elektrik
- në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjeve
- në hapësirë duhet të jetë termometri për matjen e temperaturës së ajrit
- në hapësirë duhet të jetë hygrometri për matjen e lagështisë relative të ajrit
- ta ketë derën hyrëse të punuar ashtu që ajo të mos ndikoj në ndryshimin e kushteve të ambientit në hapësirës punuese.
- të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës dhe sipas nevojës edhe me kondicioner ajri.

2.2. Temperatura e ambientit të punës në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 18 °C deri 28 °C.

2.3. Lagështia relative e ajrit në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 45% deri 75%.

2.4. Termometrat dhe hygrometrat duhet të vendosen në murin e hapësirës ashtu që të janë larg nga muri të paktën 10 cm deri 15 cm, dhe lartësi prej 150 cm deri 170 cm mbi dysheme.

2.5. Burimet e ngrohjes së hapësirës duhet të janë të paktën 1,5 m larg nga pajisjet, respektivisht nga vendi ku kryhet verifikimi dhe duhet të mundësojnë ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës.

SHTOJCA 16

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE TË CILAT PËRDOREN PËR VERIFIKIMIN E INSTALIMEVE ELEKTRIKE

Kërkesat e posaçme nga kjo Shtojcë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me standardin EN 61557.

1. ETALONËT DHE PAJISJET

- 1.1. Gjeneratori i tensionit njëkahor (1 mV deri 1000 V).
 - 1.2. Gjeneratori i tensionit alternative (1 mV deri 1000 V) me frekuencë deri 1 kHz.
 - 1.3. Gjeneratori i rrymës njëkahore (1 mA deri 10 A).
 - 1.4. Gjeneratori i rrymës alternative (1 mA deri 10 A) me frekuencë deri 1 kHz.
 - 1.5. Mjeti matës i tensionit njëkahor (0,1 mV deri 1000 V).
 - 1.6. Mjeti matës i tensionit alternativ (0,1 mV deri 1000 V) me frekuencë deri 1 kHz.
 - 1.7. Mjeti matës i rrymës njëkahore (1 mA deri 1 A).
 - 1.8. Mjeti matës i rrymës alternative (1 mA deri 1 A) me frekuencë deri 1 kHz.
 - 1.9. Mjeti matës i rezistencës (0,1 Ω deri 1 G Ω).
 - 1.10. Mjeti matës i tensionit të lartë njëkahor (1 deri 10 kV).
 - 1.11. Mjeti matës digjital i frekuencës (0 Hz deri 10 kHz).
 - 1.12. Mjeti matës i kohës (1 ms deri 100 s).
 - 1.13. Rezistuesit etalon (0,1 Ω deri 1 T Ω).
 - 1.14. Termometri me ndarje 0.1 °C për matjen e temperaturës së ajrit të ambientit të punës.
 - 1.15. Hygrometri me ndarje 0.1% për matjen e lagështisë relative të ajrit të ambientit të punës.
- Etalonët që përdoren për verifikim duhet të janë të kalibruar, ndërsa pajisjet tjera matëse të verifikuara dhe të kalibruara.
- Aftësia më e mirë matëse e etalonëve dhe pajisjeve matëse për secilën madhësi matëse dhe për diapazon të caktuar, e përcaktuar me vlerësimin e shumës së kontributit të përbërësve të caktuar të pasigurisë së matjes, duhet të jetë më e vogël se gabimi i lejuar i matjes i asaj madhësie të matur të mjetit të verifikuar matës.

2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

- 2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet ta ketë hapësirën e punës që duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - të jetë e pastër, e thatë dhe me hapësirë të mjaftueshme për verifikim të papenguar
 - të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve të nevojshme
 - të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit
 - të ketë orendi për vendosjen e mjeteve matëse të cilat testohen

- të ketë ndriçim natyral dhe elektrik
- të ketë derën hyrëse të punuar ashtu që ajo të mos ndikoj në ndryshimin e kushteve të ambientit të hapësirës punuese.
- në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjeve
- të jetë e siguruar nga depërtimi i pluhurit, avullit të ujit dhe gazrave agresivë
- në hapësirë duhet të jetë termometri për matjen e temperaturës së ajrit
- në hapësirë duhet të jetë hygrometri për matjen e lagështisë relative të ajrit
- të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës dhe sipas nevojës edhe me kondicioner ajri.

2.2. Temperatura e ambientit të punës në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 21 °C deri 25 °C.

2.3. Lagështia relative e ajrit në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 30% deri 70%.

2.4. Termometrat dhe hygrometrat duhet të vendosen në murin e hapësirës ashtu që të janë larg nga muri të paktën 10 cm deri 15 cm, dhe lartësi prej 150 cm deri 170 cm mbi dysheme.

2.5. Burimet e ngrohjes së hapësirës duhet të janë të paktën 1,5 m larg nga pajisjet, respektivisht nga vendi ku kryhet verifikimi dhe duhet të mundësojnë ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës.

SHTOJCA 17

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE TE PAJISJEVE PËR MATJEN E NIVELIT TË ALKOOLIT ETILIK NË FRYMËMARRJEN E TË ANKETUARVE

Kërkesat e veçanta nga kjo Shtojcë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me rekomandimin në fuqi të Organizatës ndërkombëtare për metrologji ligjore (International Organization of Legal Metrology) OIML R 126.

1. ETALONËT DHE PAJISJET

1.1. Bombola me tretje gjegjëse referuese të alkoolit etilik me përqendrim të caktuar saktë.

1.2. Dhomëza, respektivisht pajisja për përgatitjen e përqendrimit referues të avullit të alkoolit etilik në ajër, nëse verifikimi kryhet me të ashtuquajturën metodën e lagësht.

1.3. Mjeti matës i rrjedhjes së gazrave (nëse verifikimi kryhet me të ashtuquajturën metodën e thatë).

1.4. Pajisjet e zakonshme të laboratorit kimiko-fizik si dhe e gjithë pajisja e nevojshme për operim dhe përdorim të sigurt të bombolave të gazit (manometrat, valvulet reduktuese e ngjashëm) kur përdoret gazi i thatë referues në bombola.

1.5. Termometri etalon me diapazon matës prej 0 °C deri + 35 °C me ndarjen më të vogël prej 0,1 °C për përcjelljen e temperaturës së tretjes referuese.

1.6. Termometri me ndarje 0,1 °C për matjen e temperaturës së ajrit të ambientit të punës.

1.7. Hygrometri me ndarje 0.1 % për matjen e lagështisë relative të ajrit të ambientit të punës.

Materialet referuese duhet të verifikohen, termometri etalon duhet të kalibrohet, ndërsa të gjitha pajisjet tjera matëse me të cilat verifikohet etilometrat duhet të jenë të verifikuara ose të kalibruara.

2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

2.1. Hapësira e punës për verifikimin e etilometrave duhet t'i plotësojë këto kushte:

– të jetë e pastër, e thatë dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme për verifikimin e papenguar të mjetit matës

– të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve të nevojshme

– të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit

– në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjes

– të jetë e siguruar nga depërtimi i pluhurit, avullit të ujit dhe gazrave agresivë

– të ketë orendi për vendosjen e etilometrave të cilët testohen

– ketë ndriçim natyral dhe ndriçim elektrik

– në hapësirë duhet të jetë termometri për matjen e temperaturës së ajrit

– në hapësirë duhet të jetë hygrometri për matjen e lagështisë relative të ajrit

– të ketë derën hyrëse të punuar ashtu që të mos ndikoj në ndryshimin e kushteve të ambientit në hapësirës punuese.

– të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës dhe sipas nevojës edhe me kondicioner ajri.

2.2. Temperatura e ambientit të punës në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 18 °C deri 25 °C.

2.3. Lagështia relative e ajrit u në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 30% deri 70%.

2.4. Termometrat dhe hygrometrat duhet të vendosen në murin e hapësirës ashtu që të janë larg nga muri të paktën 10 cm deri 15 cm, dhe lartësi prej 150 cm deri 170 cm mbi dysheme.

2.5. Burimet e ngrohjes së hapësirës duhet të janë të paktën 1,5 m larg nga pajisjet, respektivisht nga vendi ku kryhet verifikimi dhe duhet të mundësojnë ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës

SHTOJCA 18

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE PAJISJEVE TË TAKSIMETRAVE

Kërkesat e veçanta nga kjo Shtojcë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me rekomandimin në fuqi të Organizatës ndërkombëtare për metrologji ligjore (International Organization of Legal Metrology) OIML R 21.

1. ETALONËT DHE PAJISJET

1.1. Trupi i emëruar duhet t'i ketë këta etalonë, këto pajisje matëse dhe ndihmëse dhe pajisje:

1.1.1. Pajisje etalon për verifikimin së rrugës së kaluar

1.1.2. Pajisje etalon për verifikimin e matjes së kohës në taksimetër.

1.1.3. Cilindra matës etalon për matjen e shpejtësisë dhe rrugës (opcionale).

1.1.4. Pajisja për verifikim dhe plotësim të shtypjes së ajrit në pneumatik.

1.1.5. Veglat dhe pajisjet tjera testuese sipas udhëzimeve të prodhuesit të taksimetrit.

1.1.6. Termometri me ndarje 0.1 °C për matjen e temperaturës së ajrit të ambientit të punës me mundësi mbajtjeje dhe regjistrimi të temperaturës së ajrit.

1.1.7. Hygrometri me ndarje 0.1% për matjen e lagështisë relative të ajrit të ambientit të punës me mundësi mbajtjeje dhe regjistrimi të lagështisë relative të ajrit.

1.2. Etalonët që përdoren për verifikimin e taksimetrave duhet të janë të kalibruar duke përfshirë edhe pajisjet tjera matëse si pajisje ndihmëse.

2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

2.1. Hapësira për verifikimin e taksimetrave duhet që:

- Poligoni (Traseja) duhet të jetë me gjatësi minimale 20 m. Kjo kërkohet në rast që TVKja nuk i posedon cilindrat matës.

- të jetë e pastër, e thatë dhe jo e rrëshqitshme.

- në hapësirë dhe përreth saj burimet e dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjeve

- kushtet ambientale në të cilat bëhet verifikimi i taksimetrave të jenë në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare.

2.2 Hapësira e brendshme për akomodim të etalonëve duhet:

- të jetë e pastër, e thatë dhe me hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve

- të ketë ndriçim natyral dhe elektrik.

- në hapësirë të jetë termometri kontrollues për matjen e temperaturës.

- në hapësirë duhet të jetë hygrometri kontrollues për matjen e lagështisë relative të ajrit.

- të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës dhe sipas nevojës edhe me kondicioner ajri.

2.3. Temperatura e ambientit të brendshëm në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 18 °C deri 28 °C.

2.4. Lagështia relative e ajrit në hapësirën brendshme të punës duhet të jetë në kufijtë prej 30% deri 80%.

2.5. Burimet e ngrohjes së hapësirës duhet të janë të paktën 1,5 m larg nga pajisjet, respektivisht nga vendi ku kryhet verifikimi dhe duhet të mundësojnë ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës

SHTOJCA 19

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE TË SHPEJTËSISË NË TRAFIKUN RRUGOR

Kërkesat specifike nga kjo Shtojcë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me rekomandimin në fuqi të Organizatës ndërkombëtare për metrologji ligjore (International Organization of Legal Metrology) OIML R91.

1. ETALONËT DHE PAJISJET

- 1.1. Gjenerator sinjali – 1 μ Hz deri 50 MHz; 1 mV deri 10 V (cetv. i sin).
 - 1.2. Matësi digjital i frekuencave – 1 mHz deri 35 GHz.
 - 1.3. Njehsori i impulseve – 0 deri 100 000.
 - 1.4. Mjeti matës VF me fuqi prej – 1 μ W deri 3 W; 100 MHz deri 35 GHz.
 - 1.5. Mjeti matës i kohës – 1 ns deri 100 s.
 - 1.6. Pajisje etaloni për verifikimin e mjeteve matëse dopler dhe laserik me shpejtësi – 30 km/h deri 250 km/h (shpejtësia e simuluar).
 - 1.7. Trupi për vlerësim të konformiteti duhet t'i ketë pajisjet testuese dhe matëse si dhe paisjet sipas udhëzimeve të prodhuesit të mjetit matës të shpejtësisë.
 - 1.8. Termometri me ndarje 0,1 °C për matjen e temperaturës së ajrit të ambientit të punës.
 - 1.9. Hygrometri me ndarje 0.1% për matjen e lagështisë relative të ajrit të ambientit të punës.
- Etalonët që përdoren duhet të janë të kalibruar, ndërsa pajisjet tjera matëse duhet të janë të verifikuara ose kalibruara.

2. HAPËSIRAT DHE KËRKESAT

- 2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirën ku kryhet verifikim i mjetit matës të shpejtësisë.
- 2.2. Hapësira për verifikimin e mjetit matës të shpejtësisë:
 - të jetë e pastër, e thatë dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme për verifikim të papenguar të mjetit matës të shpejtësisë
 - të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve të nevojshme
 - të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit
 - të ketë orendi për vendosjen e mjeteve matëse të shpejtësisë të cilat testohen
 - të ketë ndrqim natyral dhe elektrik
 - në hapësirë duhet të jetë termometri për matjen e temperaturës së ambientit
 - në hapësirë duhet të jetë hygrometri për matjen e lagështisë relative të ajrit
 - ta ketë derën hyrëse të punuar ashtu që të mundësohet kontrolli i hyrjes në këtë hapësirë
 - në hapësirë dhe përreth saj burimet e goditjeve dhe dridhjeve nuk guxojnë të ndikojnë në saktësinë e matjeve

– të jetë e pajisur me burime të nxehtësisë për ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës së punës dhe sipas nevojës edhe me kondicioner ajri

– të jetë e siguruar nga depërtimi i pluhurit, avullit të ujit dhe gazrave agresivë.

2.3. Temperatura e ambientit të punës në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej $20\text{ }^{\circ}\text{C} \pm 10\text{ }^{\circ}\text{C}$.

2.4. Lagështia relative e ajrit u në hapësirën e punës duhet të jetë në kufijtë prej 40% deri 70%.

2.5. Burimet e ngrohjes së hapësirës duhet të janë të paktën 1,5 m larg nga pajisjet, respektivisht nga vendi ku kryhet verifikimi dhe duhet të mundësojnë ngrohje të njëtrajtshme të hapësirës.

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT
PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE NË QENDRAT E KONTROLLIMIT
TEKNIK TË AUTOMJETEVE

1. ETALONËT DHE PAJISJET

1.1 Etalonët matëse për verifikimin e saktësisë së forcës frenuese të cilindrave të cilët shërbejnë për testimin e forcës frenuese të diskut të rrotës tek automjetet; Stabilimenti mekanik ose elektronik (matësi i gjysmë boshteve) me dimensione dhe formë të përshtatshme për tipe dhe peshë të caktuara të mjeteve matëse për matjen e forcës frenuese të automjeteve dhe masë/gramarë të përshtatshme të klasës së saktësisë M2, përkatësisht me krahun matës me manometër, dinamometër ose konvertues elektronik të forcës, të cilët japin të dhëna mbi forcën frenuese në diapazonin prej 0 deri 40 kN;

1.2 Etalonët matëse për verifikimin e pajisjes matëse të presionit në pneumatikët e automjeteve; Klasa e saktësisë së etalonit duhet të jetë $\pm 0.025\%$ FS me diapazon matës mbi 4 bar me aksesori të ndryshëm duke e përfshirë edhe pompa presioni deri në 30 bar

1.3 Etalonët matëse për verifikimin e saktësisë së pajisjes për testimin e ngarkesës së lejuar maksimale në boshtet e automjeteve,

1.4 Etalonët matëse për verifikimin e saktësisë së pajisjes për kontrollimin e zhurmës së automjeteve; minimum pajisje e klasit të dytë me presion të zërit në dalje 94 db ose më i mirë.

1.5 Etalonët matëse për verifikimin e saktësisë së kontrolluesve të e intezitetit dhe drejtimit të dritave : (0-120,000) cd me saktësi të matjes minimum: Intensiteti i dritës $\pm 4\%$;

1.6 Etaloni matëse verifikimin e saktësisë së pajisjes matëse për kontrollimin e thellësisë së profileve të gomave.

1.7. Etalonët matës për verifikimin e mjeteve matëse për matjen e vëllimit të komponentëve të gazrave të emetuara nga makinat motorike.

Kalibratori i gazit duhet të ketë këto karakteristika:

- Oksidi i karbonit (CO), - (0-5) % vol,
- Dioksidi i karbonit (CO₂), - (0-16) % vol,
- Oksigjen (O₂), - (0-21)% vol,
- Hidrokarburet (HC) - (0-2000) ppm vol
- Propan/Hexan, faktor ekuivalent (C₃H₈/ C₆H₁₄) – (0.490...0.540) %
- Azot(N₂) - pjesa tjetër

Rezolucioni:

- (CO), - 0.01 % vol
- (CO₂) - 0.1 % vol
- (O₂), - 0.01 vol për brezin (më të vogël se 4) % vol
- 0.1 vol për rangun (më të madh se 4) % vol

2. Hapësirat dhe Kushtet qe duhet ti posedoj trupi i emëruar
- 2.1 Të jetë e pastër, e i thatë dhe me sipërfaqe të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve, si edhe për verifikimin të pa pengueshëm të mjeteve matëse me cilindra;
- 2.2 Kushtet e ambientit të jenë stabile dhe të përshtatshme për matje.
- 2.3 Të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit;
- 2.4 Në hapësira dhe në rrethinë të mos ketë burim të vibrimit që do të ndikonte në saktësi të matjeve;
- 2.5 Të ketë ndriçim të mjaftueshëm natyror dhe elektrik;
- 2.6 Të ketë termometër për matjen e temperaturës së ambientit me ndarje prej 0.1 °C;
- 2.7 Të ketë hygrometrin me ndarje 0.1% për majtën e lagështisë relative;
- 2.8 Në hapësirat punuese të destinuara për verifikim të mjeteve matëse duhet të vendosen pajisjet për këtë qëllim dhe kjo hapësirë nuk mund të shfrytëzohet për asnjë aktivitet tjetër.
- 2.9 Temperatura e ambientit të punës në hapësirën e punës për verifikimin e mjeteve matëse duhet të jetë në kufijtë prej 10 °C deri 30 °C.
- 2.10. Burimet e nxehtësisë në hapësirat punuese për verifikimin duhet të jenë të larguara nga pajisjet, përkatësisht nga vendi ku realizohet verifikimi në distancë së paku 1.5 m si dhe duhet të krijojnë mundësinë e ngrohjes lineare të të gjithë hapësirës.
- 2.11 . Etalonët që përdoren duhet të janë të kalibruar, ndërsa pajisjet tjera matëse duhet të janë të verifikuara ose kalibruara.

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT
PËR VERIFIKIMIN E MJETEVE MATËSE LIGJORE TË TAHOGRAFËVE DHE
KUFIZUESVE TË SHPEJTËSISË

1.1. ETALONËT DHE PAJISJET

1.2. Pajisjet e përshtatshme të kontrollit në pajtim me udhëzimet e prodhuesit;

1.2.1 . Pajisja e dorës për verifikimin e tahogرافit – e përshtatshme për përdorim mobil dhe në kabinën e automjetit me softuer të përshtatshëm dhe të azhurnuar sipas kriterëve të kërkuara. Kjo pajisje shërben për përcaktimin e koeficientit karakteristik të automjetit "W", konstantës së tahogرافit "K", matjes së kohës, dhe matjen e rrugës së kaluar e matur ndërmjet dy pikave referente ku së paku i plotëson kushtet të verifikohen tahogرافët e tipit analog;

1.2.2 . Pajisje për kontrollin e regjistrimit në fletëzën e tahogرافit me fushat e shënuara për kufijtë e lejueshëm të gabimit (shabllonet sipas udhëzimit të prodhuesit të tahogرافit) dhe zmadhuesin (llupën) për leximin e fletëzës së tahogرافit;

1.2.3 . Manometër për matjen e presionit të gomave;

1.2.4 . Pajisje për matjen e perimetrit efektiv të rrotave;

1.2.5 . Shiritin matës në gjatësinë prej 30 metrave;

1.2.6 . Vulën verifikuese dhe pajisjen për shtypjen e vulës;

1.2.7 . Udhëzuesit (manualet) për verifikimin e tahogرافëve;

1.2.8 . Kompjuterin personal me printer;

1.2.9 . Për verifikimin e tahogرافit mund të përdoren vetëm pajisjet të cilat janë në pronësi të trupës që aplikon për emërim dhe posedojnë dëshmitë përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

1.2.10 Etalonët që përdoren duhet të janë të kalibruar, ndërsa pajisjet tjera matëse duhet të janë të verifikuara ose kalibruara.

2. Objekti, hapësira, pajisjet ndihmëse dhe kushtet që duhet të posedoj trupi i emëruar

2.1. Trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë objekt dhe hapësirë për verifikim, vendosjen e pjesëve dhe pajisjeve, të evidentimit të të dhënave verifikuese të tahogرافëve që janë:

2.1.1. Në përputhje me standardet dhe normat teknike;

2.1.2. Duhet të posedoj dëshminë (pëlqimin) nga organi kompetent për kyçje në rrugë publike në përputhje me dispozitat ligjore mbi rrugët;

2.1.3. Të ketë sipërfaqe të mjaftueshme që mjetet matëse, pajisjet dhe dokumentacioni i arkivuar me të gjithë dokumentacionin që lidhet me punën e trupës së emëruar, si dhe stafin, mund të vendosen në mënyrë që stafi të lejohen të lëvizin lirshëm;

- 2.1.4. Të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e tahografëve, të vendosen së paku dy tavolina punuese me gjatësi prej 120 cm, me karrige përkatëse, të paktën një raft për të vendosur pajisjet dhe mjetet për verifikim si dhe të dhënat e tahografit.
- 2.1.5. Në hapësirën punuese duhet të ketë termometrin për matjen e temperaturës së ajrit me ndarje 0.1°C;
- 2.1.6. Të ketë hygrometrin për matjen e lagështisë relative të ajrit me ndarje 0.1%;
- 2.1.7. Temperatura e hapësirës punuese duhet të jetë në kufij prej 18 deri 28 gradë;
- 2.1.8. Lagështia relative e ajrit në hapësirën punuese duhet të jetë në kufij 30% deri 80%.
- 2.2. Rrugën testuese (poligonin) ose cilindrat testues;
 - 2.2.1. Vendi i verifikimit duhet të ketë një trase (poligon testues). Në mungesë të poligonit të verifikimit mund të bëhet me ndihmën e cilindrave ose ruleve matës testues;
 - 2.2.2. Vendi verifikues duhet të jetë me sipërfaqe bashkëkohore rrugore (asfalt, beton apo materiale të tjera, i cili siguron një cilësi minimale nga shtresa e betonit ose asfaltit);
 - 2.2.3. Dimensionet e poligonit verifikues duhet të jenë sipas standardeve dhe normave teknike të përcaktuara enkas për këtë çështje në rastin kur është pa cilindra (rule) testues.
 - 2.2.4. Kur vendi i verifikimit ka trase me cilindra apo rule matës verifikues, dimensionet e trasesë duhet të kenë përmasa sipas kushteve për përdorim të cilindrave;
 - 2.2.5. Gjerësia e trasesë së poligonit që përdoret për verifikim pa cilindra verifikues duhet të jetë më së paku 3 metra. Traseja duhet të jetë e vendosur në mënyrë horizontale gjatësore në terren me një tolerance $\pm 2\%$;
 - 2.2.6. Dalja e drejtpërdrejtë nga vendi i verifikimit (poligoni i verifikimit) në hapësirën e trafikut publik duhet të bëhet i mundur me kyçjen e automjetit në trafik në mënyrë të papenguar dhe në mënyrë të sigurt;
 - 2.2.7. Vendi i destinuar për verifikim duhet të jenë në të njëjtën adresë dhe hapësirë për të cilën trupi është i emëruar, duhet të jetë e sinjalizuar në mënyrë të qartë lidhur me manovrat për verifikimin e mjetit;
 - 2.2.8. Vendi i destinuar për verifikim që është në dispozicion (nuk ka pengesa në qasje) gjatë orarit të punës, dhe nëse verifikimi kryhet në hapësira publike ose rrugë publike duhet të posedojë deshmim (pëlqimin) nga organi kompetent;
- 2.3. Kanalin, ose peshëngritësen (vinçin);
 - 2.3.1. Vendi i verifikimit duhet të ketë kanal, ose peshëngritësin i cili përdoret gjatë veprimtimit të verifikimit të tahografit, gjatësia, gjerësia duhet të jenë adekuate me distancën e boshteve të automjetit motorik në të cilin vendoset tahografi;
 - 2.3.2. Kanali ose peshëngritësi duhet të jenë jashtë sipërfaqes së trafikut publik dhe duhet të jenë të vendosur pranë hapësirës për verifikimin dhe evidentimin e tahografëve;
 - 2.3.3. Dalja e drejtpërdrejtë nga kanali, ose peshëngritësi në sipërfaqe publike të trafikut duhet të mundësojë qasje të sigurt të automjetit në trafik;
- 2.4. Hapësirën (vendin) përkatës për pranimin dhe parkimin e automjetit;
 - 2.4.1. Vendi i verifikimit duhet të ketë qasje pa problem të automjetit, në të cilin mundësohet kalimi i automjetit nga traseja në kanal, në rrëshqitës apo peshëngritës.

- 2.4.2. Në vendin e verifikimit duhet të jetë qartë e shënuar kahja e lëvizjes së automjetit dhe vendi për parkimin e tij.
- 2.4.3. Parkimi i automjetit duhet të jetë jashtë hapësirës publike dhe kjo hapësirë të jetë mjaftë e madhe që të mundë të parkohet më së paku një automjet i përmasave të automjetit motorik i cili është i pajisur me tahograf.
- 2.4.4. Që është në dispozicion (nuk ka pengesa në qasje) gjatë orarit të punës.
- 2.5. Dëshmitë që trupi i emëruar ka objektin dhe hapësirën e duhur për kryerjen e veprimtarive për të cilat po aplikon qoftë në pronësi apo i marr me qira, përfshirë këtu edhe poligonin verifikues, pajisjet dhe mjetet e nevojshme për verifikimin (cilindrat verifikues, kanalin, rrëshqitësen ose peshëngritësen (vinçin).

SHTOJCA 22

KËRKESAT QË DUHET T'I PLOTËSOJË TRUPI PËR VLERËSIM TË KONFORMITETIT PËR KONTROLLIMIN E PRODUKTEVE PËR PARAPAKETIME

1. ETALONËT DHE PAJISJET

- 1.1. Peshore jo-automatike me ndarje testuese »e« e cila e ka vlerën e =0.01g, me kapacitet maximal max=10200g dhe atë minimale 1g
- 1.2. densitometri me klase të saktësis $\pm 0.001 \text{ g/cm}^3$ dhe me lexushmeri 0.0001 g/cm^3
- 1.3. Termometri për matjen e lëngjeve me ndarje 0.1°C ose më të mirë,
- 1.4. Pyknometer i metalit qelik i pandryshkem me kapak preciz me vëllim nominal 50 ml dhe 100ml
- 1.5. Pyknometer i qelqit me termometër (Gay-Lussac)
-Termometri i pyknometrit me ndarje 0.2°C dhe rang prej 10°C deri 30°C
- 1.6. Ene vëllimore e qelqit dhe kapak
-kompleti i enëve të qelqit me vëllim nominal: 100; 250; 500; 1000 ml, dhe me klasë të saktësis A
- 1.7. Të ketë Kompjuter dhe monitor me pajisjet përcjellëse, printer;
- 1.8. Etalonët nga pikat 1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.5; dhe 1.6 duhet të jenë të kalibruara

2. Hapësirat dhe Kushtet qe duhet ti plotësoj trupi për vlerësim të konformitetit

- 2.1 trupi për vlerësim të konformitetit duhet të ketë hapësirë për kontrollimin e produkteve për parapaketimet, vendosjen e pjesëve dhe pajisjeve si dhe hapësirë për ruajtjen e dokumentacionit;
- 2.2 Tavoline antivibruese për peshore me sirtar, konstrukcion metalik, sipërfaqja e punës me trashësi minimale 28 mm;
- 2.3. Pllake porcelani e ndare nga sipërfaqja e tavolinës me rere kuarci për amortizim të vibrimeve;
- 2.4. Konstrukcioni i tavolinës tube çeliku katror i ngjyrosur me epoksi rrëshirë me rezistencë të lartë ndaj korrozionit, me mundësi nivelimi.
- 2.5. Tavolina fikse me dimensione të përshtatshme për punë;
- 2.6. Termometrën për matjen e temperaturës së ajrit me ndarje 0.2°C
- 2.7. Të ketë hygrometrin për matjen e lagështisë relative të ajrit me ndarje 0.1%.
- 2.8. set sitash me nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6,
- 2.9. degazues,
- 2.10. banjomarine,
- 2.11. një set gramarësh F2 prej 5g deri në 10kg
- 2.12. si dhe aksesor të ndryshëm.

